



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

“AUDITIMIN FINANCIAR”

Tiranë, tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projekt Raportit të Auditimit	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	7-10
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit.	7
2.	Identifikimi i çështjes.	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve.	7-8
5.	Kriteret e vlerësimit.	8
6.	Standardet e auditimit.	8
7.	Metoda e auditimit.	8-9
8.	Dokumentimi i auditimit.	9-10
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11-57
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	11
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	11-54
2.1.	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.	11-24
2.2.	Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.	24-48
2.3.	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	48-57
2.4.	Të tjera çështje përgjatë auditimit.	57
IV.	REKOMANDIME	57-67

Shkurtime

AAGJM	Aktive Afatgjata Materiale
AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AB	Auditi i Brendshëm
AK	Autoriteti Kontraktor
AMTP	Aktit Marrjes së Tokës në Pronësi
APP	Agjencia Prokurimeve Publike
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DST	Dokumentet Standarte të Tenderit
EMP	Ekipi menaxhimit të programeve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
HRMIS	Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
IDI	Nisma për Zhvillimin e INTOSAI-t
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologji Informacioni
IVMT	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
KB	Kontrolli i Brendshëm
KB	Këshilli Bashkiak
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KR	Koordinatori Riskut
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MF	Ministria e Financave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MR	Menaxhimi i Riskut
NA	Nëpunës Autorizues
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator ekonomik
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PP	Prokurime Publike
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar Qeveritar
SKK	Standarti Kombëtar i Kontabilitetit
SNK	Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit
SNKSP	Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit në Sektorin Publik
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

a. Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit.

Bashkia e Libohovës është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe dy ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 3 njësi administrative si vijon: njësia administrative Libohovë (qyteti), njësitë administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie, me qendër në Qytetin Libohovë. Bashkia ka një shtrirje territorial prej 248.24 km² dhe kufizohet Bashkitë Këlcyrë, Përmet, Dropull dhe Gjirokastrë.

Misioni i Bashkisë Libohovë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Libohovë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Libohovë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar në Bashkinë Libohovë për periudhën e aktivitetit nga 01.01.2022 deri më 31.12.2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së bashkisë.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionimi nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm.
- Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
- Verifikimi i ecursisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit

në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 18 rekomandime, nga të cilat 17 masa organizative dhe 1 masë të ardhura të munguara.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen në shumën 36,106,850 lekë, ndërsa llogaria analitike 468 “*Debitorë të ndryshëm*” nga Drejtoria e Tatim-Taksave pasqyrohet në shumën 37,042,382 lekë. Diferenca e konstatuar është në shumën 935,532 lekë, të cilat janë të pakontabilizuara;

- në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohen detyrime që shteti i ka institucionit për paga, kontribute dhe detyrime të tjera, totali i të cilave duhet të ishte kontabilizuar në debi të llogarisë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, të cilat në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohen në shumën 14,422,295 lekë, nga të cilat 7,589,885 lekë janë keqklasifikuar në llogari të tjera;

- konstatohen transaksione lidhur me rikonstrukcione që janë në punime në proces, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim, ndërkohë që janë kontabilizuar në shtesë të llogarive të aktiveve, në shumën 34,987,528 lekë, kjo diferencë duhet të ishte gjendje në llogarinë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, e për rrjedhojë gjendja e llogarisë 231 më datë 31 dhjetor 2024 duhet të ishte 352,221,635 lekë dhe jo 317,234,107 lekë;

- llogaria 7209 “*Të tjera grante korente të brendshme*” konstatohet se përfaqësojnë të ardhura të trashëguara nga vitit 2023, në shumën 54,153,560 lekë. Këto të ardhura janë kontabilizuar një herë në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe kontabilizimi i tyre edhe në pasqyrat financiare të vitit 2024 sjell një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të të ardhurave të vitit ushtrimor 2024;

- në pasqyrën e rezultatit seksioni i “*Shpenzime të tjera*”, janë përfshirë operacione të korrigjimit të rezultatit në shumën 39,534,328 lekë, të cilat nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të tilla, sepse kjo vlerë përbëhet nga transaksione për investime të financuara nga fondet buxhetore dhe jo nga fondet e veta.;

- nuk është kryer inventarizimi i pronave të paluajtshme, të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 11.07.2007, vendimit nr. 272, datë 21.04.2010 dhe vendimit nr. 706, datë 11.07.2007 dhe vendimit nr. 398, datë 13.05.2020. Bashkisë Libohovë nga 1693 asete të transferuar në përdorim/pronësi, ka të regjistruara dhe pajisur me certifikatë vetëm 7 asete;

- konstatohet se, ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Auditimi i brendshëm nuk është përqendruar plotësisht në auditimin e fushave me risk të lartë, si dhe nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- të merren masa për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet të shumës 935,532 lekë të pakontabilizuar. Të kryhen regjistrimet dhe rakordimet kontabël të debitorëve çdo fund periudhe kontabël, me qëllim pasqyrimin e saktë të debitorëve në pasqyrat financiare;
- të merren masa për pasqyrimin në pasqyrat financiare si të drejta, detyrimet për paga, sigurime shoqërore, shëndetësore, tatim mbi të ardhurat dhe detyrime të tjera afatshkurtra që bashkia ka ndaj punonjësve dhe të tretëve në fund të periudhës kontabël, me qëllim pasqyrimin e saktë të Të Drejtave dhe Detyrimeve në pasqyrat financiare;
- të merren masa të menjëhershme për sistemimin e veprimeve kontabël sipas llogarive përkatëse me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të investimeve dhe burimeve të investimeve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të teknikave kontabël. pasqyrat financiare;
- Të merren masat e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël dhe rakordimit të të ardhurave me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të tyre në pasqyrat financiare;
- Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e sistemimeve dhe regjistrimeve në kontabilitet për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të eliminohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare;
- Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Libohovë të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të kontrollit të brendshëm.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinioni për auditimin financiar¹: i kualifikuar²

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Libohovë, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese, si dhe të gjitha pasqyrat statistikore që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2024, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022. etj.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

1 - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

2 - Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 faqe 54.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë **opinion të kualifikuar**, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 3,640 mijë lekë. Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Libohovë, sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

- Nga auditimi i llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” konstatohet se detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen në shumën 36,106,850 lekë, ndërsa llogaria analitike “*Debitorë të ndryshëm*” nga Drejtoria e Tatim-Taksave pasqyrohet në shumën 37,042,382 lekë. Diferenca e konstatuar është në shumën 935,532 lekë, të cilat janë të pakontabilizuara;

- Nga auditimi i pjesës së detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohen detyrime që shteti i ka institucionit për paga, kontribute dhe detyrime të tjera, totali i të cilave duhet të ishte kontabilizuar në debi të llogarisë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, të cilat në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohen në shumën 14,422,295 lekë, nga të cilat 7,589,885 lekë janë keqklasifikuar në llogari të tjera;

- Nga auditimi i llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” konstatohet transaksione lidhur me rikonstruksione që janë në punime në proces, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim, ndërkohë që janë kontabilizuar në shtesë të llogarive të aktiveve, në shumën 34,987,528 lekë. Konstatohet se diferenca në shumën 34,987,528 lekë duhej të ishte gjendje në llogarinë 231 në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, e për rrjedhojë gjendja e llogarisë 231 më datë 31 dhjetor 2024 duhet të ishte 352,221,635 lekë dhe jo 317,234,107 lekë;

- Llogari 7209 “*Të tjera grante korrente të brendshme*” përfaqëson të ardhura të trashëguara nga vitit 2023, në shumën 54,153,560 lekë. Këto të ardhura janë kontabilizuar një herë në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe kontabilizimi i tyre edhe në pasqyrat financiare të vitit 2024 sjell një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të të ardhurave të vitit ushtrimor 2024;

- Nga auditimi i pasqyrës së rezultatit, seksioni i “*Shpenzime të tjera*” konstatohet se, në pasqyrën e rezultatit janë përfshirë operacione të korigjimit të rezultatit në shumën 39,534,328 lekë, të cilat nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të tilla, sepse kjo vlerë përbëhet nga transaksione për investime të financuara nga fondet buxhetore dhe jo nga fondet e veta.

II. HYRJA.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 622/1prot., datë 30.05.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 05.06.2025 deri në datën 07.07.2025, në subjektin Bashkia Libohovë u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S. B., Përgjegjës Grupi;
2. A. V.
3. K. F.
4. A. C.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “Kriteret e vlerësimit”. Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet.

Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

Identifikimi i çështjes.

Auditimi synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Libohovë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre Referuar programit të auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm.
- Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
- Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të Bashkisë Libohovë, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së bashkisë, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

4. Përgjegjësitë e audituesve. Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij; Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Libohovë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Libohovë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit;
- VKM-të dhe Aktet Normative mbi funksionimin dhe organizimin e institucionit;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH^{së}", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH^{së}", miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë.

6. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI -t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH.

7. Metoda e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin

në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve

dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuar në zyrën e protokollit të Bashkisë Libohovë në datë 07.07.2025, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit dhe mbi bazën e tyre u përgatit Projekt Raporti i Auditimit. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti për Projekt Raportin dhe pas shqyrtimit të tyre u hartua Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia e Libohovës është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe dy ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 3 njësi administrative si vijon: njësia administrative Libohovë (qyteti), njësitë administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie, me qendër në Qytetin Libohovë. Bashkia ka një shtrirje territorial prej 248.²⁴ km² dhe kufizohet Bashkitë Këlcyrë, Përmet, Dropull dhe Gjirokastrë.

Misioni i Bashkisë Libohovë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Libohovë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Libohovë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar në Bashkinë Libohovë për periudhën e aktivitetit nga 01.01.2022 deri më 31.12.2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, sipas legjislationit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së bashkisë.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm.

a) Mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin.

Në zbatim të pikës “1” të programit të auditimit, ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollat, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Libohovë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Libohovë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar nga kryetari i Bashkisë, nr. 700 pot, datë 20.08.2016, “**Rregullore e Bashkisë Libohovë**”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

Bashkia Libohovë ka miratuar Kodin Etik, shkresa nr. 2260prot., datë 15.11.2024, veprime në përputhje me ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik. Rregullorja e Brendshme dhe Kodi i Etikës nuk janë të afishuara në faqen zyrtare të Bashkisë.

Bashkia nuk ka procedura të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj.

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për vitin 2024, *bashkia nuk ka përcaktuar procedura për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve dhe nuk ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion.* Gjithashtu konstatohet se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Parimi 2 - Titullari / Njësia Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet mungesa e raportimeve periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB. Nga Sektorët nuk janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme nuk është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë

përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektiveve dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve.

Nëpërmjet shkresës nr. 379prot., datë 29.02.2025 është dërguar pranë MFE-së “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, për vitin e mëparshëm.

Bashkia nuk ka Plan Menaxhimi të risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë për veprime korigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm shërbimin e të cilit e merr nga ana e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Dropull nëpërmjet Akt – Marrëveshjes nr. 570prot., datë 16.04.2021, kryer ndërmjet Bashkisë Libohovë si përfitues i shërbimit dhe Bashkisë Dropull si ofertues i shërbimit.

Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësisë funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullore të brendshme të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, shkresa nr. 700prot., datë 20.08.2016 “Rregullore e Bashkisë Libohovë” e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve.

Nga auditimi konstatohet se rregullorja e brendshme e Bashkisë Libohovë nuk është rishikuar dhe përditësuar që nga viti 2016 në përputhje me ndryshimet strukturore të kryera në këtë bashki dhe për rrjedhojë funksionet dhe përgjegjësitë për punonjësit e çdo sektori nuk janë të mirë përcaktuara.

Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 63, shkresa nr. 1902prot., datë 21.12.2023, “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve në Bashkinë Libohovë për vitin 2024”, shkresën nr. 1054/1prot., datë 27.12.2023, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut si dhe Urdhrin nr. 144 datë 29.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Libohovë, për vitin 2024”, të Kryetarit të Bashkisë, është miratuar struktura e përbërë nga **94 punonjës**.

- **Struktura organizative e bashkisë.**

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.

Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.

Bashkia Libohovë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia nuk përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësive.

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Libohovë.

Përgjatë vitit 2024, janë larguar 18 punonjës, 14 nga të cilët me Kod Pune dhe janë bërë rekrutime për 16 punonjës, 13 prej të cilëve me Kod Pune.

Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimit të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimit në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore nuk është hartuar një plan me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Për vitin 2024 janë kryer nga ASPA, trajnime të ndryshme ku kanë marrë pjesë nëpunës të institucionit.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, me shkresën nr. 105prot., datë 16.01.2024, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 12, datë 16.01.2024 *“Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik”*. Në këtë urdher, komisioni ka në përbërje 9 anëtarë.

Për vitin 2024, me shkresën nr. 547prot., datë 12.03.2024, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 53, datë 12.03.2024 *“Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2025-2027, Ekipet e Menaxhimit të Programeve, EMP”*.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS, nuk dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësive publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*, pika 2.2.1 *“Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK”* a, b, c, d, pika 2.3.1; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, Kreu II. *“Dosja e Personelit”* dhe me *“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, miratuar me Urdhërat e Ministrisë të Financave nr.8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III *“Komponentët e MFK”* pika 3.1, Kapitulli IV *“Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”*, Kapitulli V, Aneksat.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia nuk ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026, por ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027. Në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2025-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 53, datë 12.03.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor afatmesëm 2025-2027”. Ky dokument nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.

Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operationale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar. Rezulton se objektivat e miratuara nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet e-mailit apo shkresave zyrtare.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priorizimin e risqeve të përputhshmërisë. Nuk ka urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimet mbi risqet, nuk janë hartuar strategjia dhe regjistri i riskut, për vitin 2024, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Libohovë.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Libohovë ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR” dhe me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhërat e Ministrisë të Financave nr. 8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Aneksët.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”.

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiave. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

Në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.) Në zbatim të Udhëzimit nr. 01, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjister është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollin e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.

Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësisë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

- Gjurma e auditimit.

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi” dhe me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhërat e Ministrisë të Financave nr.8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Aneksat.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”.

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.*

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se nuk janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.

Bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Bashkia nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2 dhe me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Aneksat.

V. Komponenti: “Monitorimi”.

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Bashkia Libohovë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 376prot., datë 25.02.2025 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet Njësia e Auditimit të Brendshëm, shërbimin e të cilit e merr nga ana e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Dropull nëpërmjet Akt Marrëveshjes nr. 570prot., datë 16.04.2021, kryer ndërmjet Bashkisë Libohovë si përfitues i shërbimit dhe Bashkisë Dropull si ofertues i shërbimit.

-Bashkia Libohovë nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi. Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

NJAB e cila kryen shërbimin e auditit të brendshëm për Bashkinë Libohovë ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, planin vjetor të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1 dhe me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhërat e Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit;
- Për vitin 2024 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK;
- Rregullorja e brendshme e bashkisë është e datës 20.08.2016 dhe nuk reflekton ndryshimet në strukturën e bashkisë. Gjithashtu vlen të theksohet se në strukturën e Bashkisë Libohovë nuk ka asnjë drejtori dhe kjo strukturë e ka ndërtuar veprimtarinë e sajë në bazë sektori;

- Në strukturën organizative nuk janë përcaktuar qartë ndarja e detyrave konkrete ligjore që do kryhet dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti si dhe të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
 - Në Bashkinë Libohovë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”;
 - Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës.
 - Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut; Bashkia nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.
 - Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Libohovë;
 - Në Bashkinë Libohovë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes së të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i pranishëm. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar është evident;
 - Takimet e GMS nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale.
 - Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj, në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar;
 - Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. L. H, me detyrë Kryetar i Bashkisë, z. Xh. T., me detyrë Nënkryetar i Bashkisë dhe znj. F. B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

b) Mbi funksionimin dhe veprimtarinë e auditit të brendshëm.

Në zbatim të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njesisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Libohovë;
2. Plani strategjik dhe vjetor i auditimit, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2024;
4. Realizimi i programit të auditimit;
5. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
6. Rekrutimi i punonjësve në NJAB, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshtkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njesisë së auditit të brendshëm.

Auditimi i Brendshëm në Bashkinë Libohovë, është siguruar *si shërbim auditimi* me akt marrëveshjen të lidhur midis titullarëve të njesisë Bashkia Dropull dhe Libohovë, me nr. 328/1prot., të ofertuesit dhe nr. 319prot., të përfituesit, datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1prot., datë 01.04.2016, **rikonfirmuar** me shkresën e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8447prot., datë 12.05.2021, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6, shkronja “a”, “Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, *e cila jep shërbim dhe në Bashkinë Libohovë* në mbështetje të Akt marrëveshjes, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, e cila, për vitin 2024 funksionon në nivel drejtorie.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Dropull, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2024, është organizuar me 5 punonjës, në nivel drejtorie me strukturë 1 drejtues njësie, 1 përgjegjës sektori dhe 3 auditues.

Njësia e Auditit të Brendshëm përgjatë vitit 2024, ka në përbërjen e saj 3 punonjës, përkatësisht 1 drejtues, 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist auditimi, ku i gjithë stafi është i certifikuar. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e sektorit të Auditit të Brendshëm.

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2023							
1.	S.K	Drejtori i Njesisë	04.04.2016	Ekonomist	39	31	Ne vitin 2005	Po
2.	M.M	Përgjegjës Sektori	01.04.2016	Ekonomiste	35	28	Ne vitin 2005	Po
3.	A.P	Auditues	20.04.2018	Financier	15	5	Ne vitin 2019	Po

Burimi: NJAB Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron aktivitetin Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Grupi i auditimit shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, ku konstaton se dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si me poshtë:

1. Karta e Auditimit të Brendshëm e Njesisë së Auditimit Bashkia Dropull, (që kryen shërbim dhe në Bashkinë Libohovë), miratuar me Vendimin nr. 4, datë 18.10.2017, protokolluar me nr. 1356prot., datë 18.10.2017, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1367prot., datë 20.10.2017, është **përmirësuar** me Vendimin nr. 1, datë 13.10.2020, protokolluar me nr. 1916, datë 13.10.2020, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1916/1prot., datë 13.10.2020.

2. Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm i Njesisë së Auditimit Bashkia Dropull, (që kryen shërbim dhe në Bashkinë Libohovë), miratuar me Vendimin nr. 2, datë 13.10.2020, protokolluar me nr. 1915/1prot., datë 13.10.2020, i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1915/2prot., datë 13.10.2020.

3. Regjistri i riskut, është hartuar sipas kërkesave të Kreu III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, pika 3.1.2 “Identifikimi dhe vlerësimi i riskut”, miratuar me shkresën nr. 343prot., datë 22.04.2024.

4. Plani strategjik si dhe plani vjetor, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të Seksionit 3, Kreu II të MABP, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kap. III, pika 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm”, të cilat janë miratuar me shkresën nr. 1487prot., datë 17.10.2023, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1471/1prot., datë 19.10.2023, i cili është rishikuar dhe miratuar me shkresën nr. 2383prot., datë 02.12.2024, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1631prot., datë 02.12.2024.

Plani vjetor i auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kritere e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2024, janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë, ku drejtimit kryesore të auditimit për Bashkinë Libohovë, kanë qenë:

- Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, deri në fund të vitit 2023;

- Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura, për Bashkinë Libohovë, deri në fund të vitit 2023;

- Vlerësimi i hartimit të buxhetit, veprimtaria financiare Njesisë, menaxhimi i burimeve njerëzore, vlerësimi i kontrollit të brendshëm, etj., për veprimtarinë e vitit 2023;

- Vlerësimi mbi funksionimin e Njesisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimet.

5. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar **Raporti Vjetor i**

veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse, pyetësorin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, si dhe vlerësimin e kontrollit të brendshëm, miratuar nga Titullari i njësisë dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 240prot., datë 14.02.2025.

Veprimtaria e AB për periudhën 2024, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj (i ndryshuar) në përputhje me standardet, procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB, e cila paraqitet si me poshtë:

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2024.

Plani strategjik për periudhën 2024 – 2026, si dhe plani vjetor për vitin 2024, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të “Manualit për Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik”, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të cilat janë miratuar nga Titullari i Bashkisë Libohovë, me shkresën nr. 1487prot., datë 17.10.2023, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1471/1prot., datë 19.10.2023, i cili është rishikuar dhe miratuar me shkresën nr. 2383prot., datë 02.12.2024, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ne Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1631prot., datë 02.12.2024.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet plani strategjik 2024-2026 për Bashkinë Libohovë

Nr.	SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE					
	Viti planifikuar 2024	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti I planif+1 2025	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti I planif+2 2026	Niveli i Riskut (V. planif.+2)
a.	1	2	3	4	5	6
II	Bashkia Libohove		Bashkia Libohove		Bashkia Libohove	
1	Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkisë.	I mesëm			Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkisë.	I mesëm
2	Vlerësim sistemi mbi prokurimet publike.	I lartë			Vlerësim sistemi mbi prokurimet publike.	I lartë
3			Vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore	I mesëm		
4			Vlerësimi i sistemit mbi administrimin e ujërave, pyjeve,	I larte		

			livadheve dhe kullotave.			
5	Vlerësimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.	I mesëm			Vlerësimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.	I mesëm
6	Vlerësimi i shërbimit urban dhe shërbimeve publike.	I mesëm	Vlerësimi i shërbimit urban dhe shërbimeve publike.	I mesëm	Vlerësimi i shërbimit urban dhe shërbimeve publike.	I mesëm
7			Vlerësimi i funksionimit të Policisë Bashkiake.	I mesëm		
8			Vlerësimi mbi funksionimin e Njesisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.	I mesëm		
9	Vlerësimi i funksionimit të Njësive administrative.	I mesëm			Vlerësimi i funksionimit të Njësive administrative.	I mesëm
10	Vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura	I mesëm	Vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura	I mesëm	Vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura	I mesëm
11	Vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve.	I lartë	Vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve.	I lartë	Vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve.	I lartë

Në zbatim të planit vjetor, janë miratuar programet për auditimin e 4 subjekteve, ku 3 prej tyre kanë qenë të planifikuara, ndërsa një auditim është kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, si më poshtë:

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit									
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit							Zb.Rek
				Përputh	Financ	Kombin	Perform	Tematik	IT		
1	Viti 2024	4	4	3						1	

Ndërsa sipas fushave dhe vlerësimit të riskut auditimet e realizuara paraqiten:

Nr.	Subjekte të Audituarra sipas viteve		
	Planifikuar 2024	Realizuar 2024	Niveli i Riskut
1	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	I lartë
2.	Vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura	Vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura	I mesëm
3.	Vlerësimi i hartimit të buxhetit, veprimtaria financiare e Njesisë, menaxhimi i burimeve njerëzore, vlerësimi i kontrollit të brendshëm.	Vlerësimi i hartimit të buxhetit, veprimtaria financiare e Njesisë, menaxhimi i burimeve njerëzore, vlerësimi i kontrollit të brendshëm.	I mesëm
4.	Vlerësimi mbi funksionimin e Njesisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit.	Vlerësimi mbi funksionimin e Njesisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit	I mesëm

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar **Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse, pyetësorin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, si dhe vlerësimin e kontrollit të brendshëm**, miratuar nga Titullari i njësisë dhe dërguar te Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 24prot., datë 14.02.2025.

Në zbatim të kërkesës së Titullarit të Bashkisë, për realizimin e një auditimi përputhshmërie në Njësinë e MZSH- së, Bashkia Libohovë, NJAB ka realizuar auditimin sipas programit të angazhimit me nr. 2382/5prot., datë 02.12.2024, “Vlerësimi i funksionimit të Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, me periudhë 01.09.2023 deri më 31.10.2024, auditim i cili është realizuar 01.12.2024 deri me 28.12.2024.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2024, rezulton se janë dhënë 22 rekomandime gjithsej duke përfshirë edhe 9 rekomandime të lëna nga auditimi i kryer në zbatim të kërkesës së Titullarit të Bashkisë Libohovë “Vlerësimi i funksionimit të Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave në total janë zbatuar 3 rekomandime, janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe pa zbatuar 16 rekomandime. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi) në 000/lekë			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa Zbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2024	22	3	3	16	5280			5280
Totali		22	3	3	16	5280			5280

Burimi: NJAB Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga auditimi mbi dosjet e NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi, konstatohet se në përgjithësi janë mbajtur në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, ku në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme, por u konstatuan dhe problematika, konkretisht:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

-Nuk është kryer vlerësimi i riskut për çdo subjekt/fushë që përbën objekt të auditimit nga NJAB. Konkretisht nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se vlerësimi i riskut është bërë për 5 subjekte/fusha auditimi, ndërkohë janë 21 subjekte/fusha objekt i punës audituese të NJAB Bashkia Libohovë;

-Për periudhën 2024, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Libohovë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Prokurimeve, Sektorin e Tatim Taksave, Sektori i Bujqësisë, pasi për fusha të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit.

2.2. Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare.

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2024;
- 2- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024;
- 3- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2024;
- 4- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2024;
- 5- Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024;
- 6- Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2024;

7- Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2024;

8- Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2024.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për periudhën objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar për miratim në Degën e Thesarit Gjirokastër.

Konstatohet se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarë të mbajtur në programin excel, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Bashkinë Libohovë, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit Gjirokastër.

Pasqyrat Financiare janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

Për vitin 2024 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Bashkisë Libohovë pranë Degës së Thesarit Gjirokastër me shkresën nr. 600 prot., datë 27.03.2025 “Mbi dërgimin e pasqyrave financiare 2024” protokolluar nga dega e thesarit Gjirokastër me nr. 377prot., datë 28.03.2025.

Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse drejtat dhe detyrimet janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Në kuadër të standardeve të raportimit financiar (SNK 1) objektivi i pasqyrave për qëllime të përgjithshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar. Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të

tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).

Pasqyra financiare

Në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar. Pasqyrat Financiare kanë për qëllim që të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, të sigurojnë informacion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.

Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare, në radhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë apo institucionin raportues, nëpërmjet sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave monetare, lidhur me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe ato të vitit 2023 konstatohet se tepricat e pasqyruara në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në pasqyrat e vitit 2023 përputhen me tepricat në çelje të vitit ushtrimor 2024 në pasqyrat e vitit 2024.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Libohovë konstatohet se:

1. Pasqyra e pozicionit financiar

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2024

a- Të drejtat (Aktivet)	1,398,818 mijë lekë
b- <u>Detyrimet (Pasivet)</u>	<u>60,560 mijë lekë</u>
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	1,338,257 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto 1,338,257 mijë lekë.

1.1. Të Drejtat

Të Drejtat, më datë 31 dhjetor të periudhës së auditimit pasqyrohen dhe përbëhen dhe pasqyrohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur.

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2023 Aktivete afatshkurtra kanë zënë 12% të totalit të Të Drejtave në vlerë 161,299 mijë lekë, ndërsa Aktivete afatgjata kanë zënë 88% të totalit, në vlerë 1,191,409 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 ky raport ka ndryshuar, më konkretisht aktivete afatshkurtra kanë zënë 10% të totalit të Të Drejtave në vlerë 141,959 mijë lekë ndërsa aktivete afatgjata kanë zënë 90% të totalit, në vlerë 1,256,858 mijë lekë.

Ndryshimi në Aktivete afatshkurtra gjatë vitit 2024 është në rënie në vlerë me 19,339 mijë lekë, në raport me peshën specifike të totalit të Të Drejtave është në rënie me 2%. Ky ndryshim është efekt i rënies së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, rritjes së inventarit qarkullues dhe llogarive të arkëtueshme, dhe konkretisht i rënies së tepricës së mjeteve monetare, shtimit të inventarit qarkullues, rënies së detyrimeve të debitorëve ndaj njësisë si dhe rënies së shpenzimeve të periudhave të ardhshme. Ndërsa ndryshimi në Aktivete afatgjata gjatë vitit 2024 ka ardhur në rritje me 2% sa i përket peshës specifike që zënë aktivete afatgjata në raport me totalin e Të Drejtave dhe në rritje në vlerë me 65,449 mijë lekë. Ky ndryshim i atribuohet vetëm aktiveve afatgjata materiale.

1.a Aktivete afatshkurtra (qarkulluese) AASH

Aktivet Afatshkurtra për vitin 2024 janë mbyllur me tepricë në shumën 141,959,562 lekë pasqyrohen në aneksin nr. 2, bashkëlidhur.

Ato përbëhen nga shumat e rubrikave që përfaqësojnë:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 85,215,303 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 13,804,999 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 36,106,850 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 6,832,410 lekë;

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të periudhës objekt auditimi në fund të vitit ushtrimor mbyllet me tepricë në vlerë 85,215,303 lekë. Tepricat në mbyllje të vitit ushtrimor rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të pasqyrës së fluksit monetar. Nga rakordimi me degën e thesarit lidhur me llogarinë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, llogarinë nr. 466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave nuk konstatohen mosrakordime.

Llogaria nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare objekt auditimi paraqitet në tabelën nr. 3 në aneks. Në mënyrë analitike përbëhet nga grantet qeveritare të trashëguara në shumën 50,125,364 lekë, fondet e veta të trashëguara në shumën 25,058,588 lekë, si dhe mjetet në ruajtje në shumën 10,031,351 lekë të pasqyruara në aneksin nr. 3, bashkëlidhur.

Llogaritë e Klasës 3,

Aktivitet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njësisë të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor.

Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Libohovë në 31.12.2024, teprica e kësaj klase mbyllet në shumën 13,804,999 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 1,433,678 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në shumën 12,371,321 lekë të pasqyruara në tabelën nr. 4 në aneks.

Diferencat me vitet e mëparshme përfaqësojnë lëvizjet e inventarit, konkretisht për vitin 2024-2023 ndryshimi është në shumën 767,259 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (- 767,259) lekë.

Nga auditimi i librave të magazinës të vitit 2024 konstatohet se gjendja e llogarive kontabël në kontabilitetin e njësisë është e kuadruar me gjendjen e kontabël të librave të magazinës.

▪ **Llogaritë Klasës 4** “Llogari të arkëtueshme” përbëhen llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 36,106,850 lekë të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 5 në aneks:

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në pasqyrën e pozicionit financiar mbyllet me tepricë 0 lekë. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në pasqyrat financiare të NJQP paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme.

Nga auditimi i pjesës së detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohen detyrime që shteti i ka institucionit për paga, kontribute dhe detyrime të tjera totali i të cilave duhet të ishte kontabilizuar në debi të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e detyrimeve 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467 të cilat në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohen në shumën 14,422,295 lekë të cila janë keqklasifikuar në llogaritë e tjera.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” përfaqëson detyrimet që kanë të tretët ndaj Bashkisë Libohovë e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepricë në shumën 36,106,850 lekë.

Nga auditimi i llogarisë analitike të debitorëve konstatohet se ato përbëhen nga detyrime të ndryshme ndaj bashkisë në shumën 11,921,491 lekë si dhe nga debitorë të tatim taksave në shumën 25,120,891 lekë. **Konstatohet** se detyrimet e pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk rakordojnë me totalin e detyrimeve në raportin analitik në shumën 37,042,382 lekë. Diferenca e konstatuar është në shumën 935,532 lekë, të cilat janë të pakontabilizuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar

në lekë

Lloji i detyrimit		Detyrimet me 31.12.2023	Shtuar	Paksuar	Detyrime gjendje 31 dhjetor 2024
Debitorë Tatim Taksë	Detyrime Individe te ndryshem	11,921,491	-	-	11,921,491
	Taksë mbi ndertesat	4,699,740	2,038,078	2,190,879	4,546,939
	Taksë mbi token buqësore	7,711,997	2,016,881	2,416,493	7,312,385
	T/B/V 7002100	4,348,191		456,360	3,891,831
	Taksë mbi ndertimet	-	800,000	152,885	647,115
	Taksë trualli	595,254	318,913	334,860	579,307
	Tarifë ndricimi rrugor	1,228,320	516,850	523,690	1,221,480
	Tarifë pastrimi	2,277,850	1,594,500	1,700,470	2,171,880
	Tarife per ujitje	1,461,400	600,000	810,200	1,251,200
	Zenia e hapësirës publike		31,000	25,080	5,920
	Kamata	2,864,223		5,969	2,858,254
	Qera nga toka bujqësore	180,480	317,860	276,100	222,240
	Tarife blegtorale	417,220		4,880	412,340
	37,706,166	8,234,082	8,897,866	37,042,382	

Burimi: Pasqyra Financiare Bashkia Libohovë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Debitorët sipas kategorive pasqyrohen ne tabelën e mëposhtme:

	Realizimi 2023	Vlera e kontabilizuar 2023	Plani 2024	Realizimi 2024	Diferenca Plan- Fakt 2024	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar Ne fund 2024
						Krijuar 2024	Vlera progresive	
Biznesi i vogel	722,449	4,951,246	796,760	788,340	8,420	8,420	5,075,284	5,075,284
Biznesi i madh	624,415	-	749,800	749,800	-	-		
Familjaret	3,808,654	17,969,206	6,039,760	3,822,845	2,216,915	2,216,915	19,110,075	19,110,075
Totali								24,185,359

Nga bashkia janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve duke bërë njoftim-vlerësimet përkatëse, bllokime të llogarive bankare, si dhe vendosje të barreve sigurorese, me shkresat sipas tabelës së mëposhtme:

2024	Masat Shtrënguese	NR
	Njoftim vlerësimet	Nr:115,1002,1248
	Bllokime ne llog bankare	Nr:1407
	Barre Sigurorese ne ASHK/DRSHTRR	Nr:1408

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 995/7prot., datë 01.09.2025, protokolluar në KLSH me nr. 625/3prot., datë 04.09.2025, nga z. Xh. S, me detyrë Shef i Sektorit të Tatim-Taksave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Nga konstatimi juaj se detyrimet e pasqyruara në pasqyrën financiare nuk rakordojnë në tabelën e detyrimeve në raportin analitik në shumën 37.042.382. Diferenca e konstatuar është në shumën 935.532 lekë, të cilat janë të pa kontabilizuara. Në shumën për të cilën me është lënë detyrë për ta kontabilizuar është e zërit takse mbi ndërtimet në vlerën 647.115 lekë. Përsa i përket kësaj takse që vjen si plan nga Sektori i Shërbimit Urban po sqarojmë se është parashikim mbi ndërtimet e reja për vitin ushtrimor dhe jo si detyrim individual, dhe si e tillë kjo debi nuk kontabilizohet në fund të vitit. Këtë debi nuk kemi kujt t'ia tarifojmë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se, në konstatimin tonë jemi mbështetur në të dhënat e pasqyrave financiare vënë në dispozicion nga bashkia, ku kemi krahasuar llogaritë sintetike me ato analitike lidhur me debitorët e ndryshëm, llogaria 468, ku dhe është konstatuar diferenca dhe në rastin konkret nuk i jemi referuar planit të të ardhurave. Për sa sqarojmë komenti juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin e Auditimit.

Llogaritë Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në shumën 6,832,410 lekë.

Shpenzimet e periudhave të ardhshme përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avance dhe të tjera.

Kjo llogari ka ardhur në rënie në krahasim me periudhën e mëparshme kontabël me 6,922,502 lekë. Llogaria analitike mbi gjendjen e pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohet në tabelën nr. 6 në aneks.

Nga auditimi konstatohet se transaksionet e kontabilizuara në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” që i përkasin Furnizuesit të Shërbimit Universal në shumën 6,143,328,71 lekë janë shpenzime për energji elektrike për institucionin të cilat kanë ndodhur në periudhat e mëparshme kontabël. Këto shpenzime në momentin e likuidimit të tyre ngarkojnë me pa të drejtë shpenzimet e periudhës kur bëhet likuidimi i tyre duke ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin e periudhës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4.”

Nga auditimi i shpenzimeve të raportuara **konstatohen** shpenzime gjyqësore për vendimin nr. 605, date 19.04.2024 i gjykatës administrative të apelit në shumën 2,676,886 lekë i cili nuk është njohur në kontabilitetin e bashkisë ndërkohë që janë bërë pagesa për ekzekutimin e këtij vendimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 34.

1.1.b Aktivet Afatgjata.

AAGJ përbëhen nga aktivet afatgjata jomateriale në shumën 7,017,614 lekë, aktivet afatgjata materiale në shumën 856,207,326 lekë, aktivet afatgjata financiare në shumën 76,399,26 lekë si dhe investimet në shumën 317,234,107 lekë sipas tabelës nr. 7 në aneks:

Aktivt afatgjata jomateriale përbëhen nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në shumën 7,017,614 lekë dhe përbëhet në mënyrë analitike sipas tabelës nr. 8 në aneks:

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” të vitit 2024, llogaria 202 nuk ka pasur ndryshime sipas tabelës nr. 8 në aneks:

Gjithashtu **konstatohet** se kjo llogari nuk i është nënshtruar amortizimit duke bërë që vlera e kontabël të mos ndryshojë që nga njohja e transaksionit. Mosaplikimi i amortizimit për këtë llogari është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes

dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%...;”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

Aktivitet Afatgjata Materiale pasqyrohen sipas tabelës së mëposhtme dhe përbëhen nga:

- a- Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” mbyllet me tepricë në shumën 305,808,319 lekë;
- b- Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” mbyllet me tepricë në shumën 492,401,510 lekë;
- c- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” mbyllet me tepricë në shumën 27,373,588 lekë;
- d- Llogaria 215 “Mjete transporti” mbyllet me tepricë në shumën 15,459,533 lekë;
- e- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” mbyllet me tepricë në shumën 15,164,375 lekë.

Llogaritë përbërëse të AAM analizohen sipas tabelës nr. 9 në aneks:

-Llogaria 210 “Toka, troje, Terrene”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 0 lekë. Konstatohet se me vendimet e këshillit të ministrave nr. 415 datë 11.07.2007, vendimit nr. 272 datë 21.04.2010 si dhe vendimit nr. 706 datë 11.07.2007 Bashkisë Libohovë i kanë kaluar në pronësi toka, troje dhe terrene sipas tabelës nr. 9 në aneks:

-Llogaria 211 “Pyje, kullota plantacione”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 0 lekë **Konstatohet** se me vendimet e këshillit të ministrave nr. 415 datë 11.07.2007, vendimit nr. 272, datë 21.04.2010 si dhe vendimit nr. 706 datë 11.07.2007, Bashkisë Libohovë i kanë kaluar në pronësi pyje dhe kullota sipas tabelës nr. 9 në aneks:

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 305,808,319 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 272,570,167 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 212 është shtuar me një vlerë prej 34,987,528 lekë dhe është pakësuar/amortizuar llogaritur në shumën 1,749,376 lekë. **Konstatohet** se shtesa në shumën 34,987,528 është rikonstruksion i shkollës Nepravishtë i cili është rikonstruksion në proces dhe nuk duhet të kapitalizohej derisa të përfundonte rikonstruksioni dhe të merrej në dorëzim. Konstatohet se si metodë amortizimi është përdorur metoda me “Vlerë të mbetur” dhe normë amortizimi vjetore 1% të pasqyruara sipas tabelës nr. 9 në aneks.

Norma e aplikuar nga subjekti në masën 1% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon ...”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 492,401,510 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 482,824,048 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 213 është shtuar me një vlerë prej 10,081,539 lekë dhe është pakësuar në shumën 504,077 lekë për amortizimin vjetor. Është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlerë të mbetur” dhe normë amortizimi vjetore 0.1% sipas tabelës nr. 9 në aneks.

Norma e aplikuar nga subjekti në masën 0.1% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon ...”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 27,373,588 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 11,202,532 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi kjo llogari është shtuar me 35,377,071 lekë dhe është pakësuar/amortizuar, llogaritur gjatë vitit në shumën 19,206,014 lekë. Nga pakësimet e vitit shuma 18,354,906 lekë është keqklasifikuar në këtë llogari dhe janë bërë sistemimet përkatëse, por **konstatohet** se vetëm 9,436,024 lekë janë riklasifikuar, ndërsa diferenca prej 8,906,294 lekë nuk është debituar në asnjë nga llogaritë kontabël. **Konstatohet** se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 4% sipas tabelës nr. 9 në aneks.

Norma e aplikuar nga subjekti në masën 4% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi...;”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5.

-Llogaria 215 “Mjete transporti”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 15,459,533 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 13,827,533 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi kjo llogari është shtuar në shumën 2,040,000 dhe është pakësuar/amortizuar, llogaritur gjatë vitit në shumën 408,000 lekë. **Konstatohet** se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 3% sipas tabelës nr. 9 në aneks.

Norma e aplikuar nga subjekti në masën 3% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi...;”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 15,164,375 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 10,333,575 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi konstatohet se llogaria 218 është shtuar me një vlerë prej 6,280,231 lekë dhe është pakësuar/amortizuar, llogaritur gjatë vitit në shumën 1,449,430 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 8% sipas tabelës nr. 9 në aneks.

Norma e aplikuar nga subjekti në masën 8% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili përcakton se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi...;”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

Aktivet afatgjata financiare përbëhen nga:

-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 76,399,726 lekë. Kjo shumë përfaqëson vlerën e pjesëmarrjes së subjektit në “Shoqërinë Ujësjiellës kanalizime Gjirokastër” me 2.75% të aksioneve, në vlerën 76,399,726 lekë.

Investimet.

Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 "Investime", pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar.

Investimet përbëhen nga llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" dhe pasqyrohen në shumën 317,234,107 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo llogari si kundërparti të saj ka llogaritë 105 dhe 106 dhe 115 të fondit të konsoliduar. Nga auditimi **konstatohet** se llogaria 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" dhe llogaria 106 "Teprica e granteve kapitale të huaja" dhe llogaria 115 "Nga Fondet e veta të investimeve" në fondin e konsoliduar pasqyrohen në shumën 0 lekë. Investimet në proces pasqyrohen sipas tabelës nr. 10 në aneks.

Nga auditimi i llogarisë analitike "Investime për aktive afatgjata materiale", konstatohet se shtesat e investimeve gjatë vitit 2024 kanë qenë në shumën 39,986,916 lekë dhe pakësime në të njëjtën shumë 39,986,916 lekë. Pakësimet e llogarisë 231 janë mallra, shërbime dhe punime të marra në dorëzim të cilat janë kapitalizuar në llogaritë e klasës 2. Nga analiza e transaksioneve **konstatohet** se transaksionet lidhur me rikonstrukcionin e shkollës Nepravishtë janë punime në proces të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim, ndërkohë që janë kontabilizuar në shtesë të llogarisë 212 "Ndërtime e Konstruksione". **Konstatohet** diferenca në shumën 34,987,528 lekë, e cila duhet të ishte gjendje në llogarinë 231 në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, prandaj gjendja e llogarisë 231, në datën 31 dhjetor 2024 duhet të ishte 352,221,635 lekë dhe jo 317,234,107 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.*"

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare", paragrafi 27 i SNKSP 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare". Gjithashtu, paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 5.

1.2 Detyrimet

Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Libohovë në datën 31 dhjetor të secilës periudhë kontabël kundrejt, punonjësve për paga, organeve tatimore për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kreditorëve për mjetet në ruajtje të cilat janë fondet e ngurtësuar lidhur me garancitë e kontratave mes subjekteve dhe bashkisë si dhe operacioneve me shtetin.

Detyrimet në datat e mbylljes së periudhave ushtrimore përbëhen vetëm nga detyrimet afatshkurtra dhe paraqiten në tabelën nr. 12 në aneks dhe përbëhen nga:

- Llogaria 401-408, "Furnitorë e llogari të lidhura me to" përfaqëson shumën e detyrimeve që institucioni ka ndaj ofruesve të shërbimeve ose mallrave, e cila më mbyllje të periudhës kontabël mbyllet në shumën 0 lekë.

- Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit" e cila përfaqëson shumën e pagave neto të personelit të muajit dhjetor në shumën 5,329,368 lekë, për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Konstatohet se, për periudhën e auditimit detyrimi për pagat neto rakordojnë me vlerat sipas listëpagesave E-sig025.

- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” përfaqëson tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024, në shumën 403,687 lekë. Kjo teprice në mbyllje të vitit ushtrimor rakordon me listëpagesën e deklaruar në organet tatimore.

- Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” përfaqësojnë vlerën e kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor për vitin 2024. Këto detyrime në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen përkatësisht në vlerat 1,535,300 dhe në vlerën 221,530 lekë. Këto teprice në mbyllje të vitit ushtrimor rakordojnë me detyrimet sipas listëpagesës së deklaruar në organet tatimore në sistemin C@ts.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve. Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2024 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël 10,031,351 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave për mallra dhe shërbime të cilat do tu kthehen të tretëve sipas kushteve të kontratave.

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” përfaqëson detyrimet e tjera për t’u paguar, të cilat nuk rezultojnë nga marrëdhëniet tregtare. Kjo llogari në datën e mbylljes së pasqyrave financiare mbyllet në shumën 6,832,410 lekë sipas tabelës nr. 13 në aneks:

Nga auditimi i llogarisë analitike konstatohet se ajo përbëhet nga detyrime të bashkisë ndaj subjekteve private kryesisht për investime (rikonstruksione) dhe nga detyrime për energjinë elektrike. Detyrimet e mësipërme janë detyrime që burojnë nga marrëdhënie tregtare kontraktuale të cilat janë të keqklasifikuara në këtë llogari. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Detyrimet e prapambetura sipas llojit paraqiten si më poshtë:

Lloji i detyrimit/Në lekë											
Detyrimet total në fund të vitit 2024	Paga	Detyrimet për likuidimin e fatu-rave tatimore për shpenzime korren-te (mallra,shërbime e mirëmbajtje)	Detyrimet për likuidimin e faturave tatimore për investime	Detyrimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore		Detyrimet për likuidimin e huave afatgjata	Shpronësime	Të tjera	Totali i detyrimeve në fund të vitit 2024	Shtesa gjatë vitit 2024	Vlera e detyrimeve të raportuara në kontabilitet (llog. 467)
				Detyrimi sipas vendimit gjyqësor	Shpenzime përmbaruesesi						
6,832,410	0	6,572,010	260,400	0	0	0	0		6,832,410	0	6,832,410

1.3 Fondet Neto

Nga auditimi konstatohet se Aktivet neto plotësojnë rregullin Të Drejta – Detyrime = Fondi i Konsoliduar. Fondi i Konsoliduar përbëhet nga llog 101 “Fondi i akumuluar”, i cili për vitin 2024 mbyllet me tepricë në shumën 1,208,920,328 lekë, llogaria 12 “Rezultatet e mbartura” në shumën 54,153,560 lekë si dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor 2024 në shumën 75,183,952 lekë, të pasqyruara në tabelën 14 në aneks.

Fondi i Konsoliduar është rezultat i llogarive sintetike të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Nga auditimi i Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, tepricat e llogarive në fund të periudhave ushtrimore pasqyrohen në tabelën 15 në aneks:

Nga auditimi konstatohet se totali fondeve neto në të dy pasqyrat rakordon por tepricat e llogarive të cilat ndikojnë dhe përbëjnë seksionin e tretë të pasqyrës së pozicionit financiar të cilat konvergojnë nga pasqyra e ndryshimeve në fondet neto nuk rakordojnë dhe **konstatohen** diferenca mes së njëjtës llogari në të dyja pasqyrat duke bërë që të arrijmë në konkluzionin se tepricat e pasqyruara nuk na japin një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2024. Konkretisht, **konstatohet** se llogaria 12 “Nga Rezultatet e mbartura” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 54,153,560 lekë ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet

neto pasqyrohet në shumën 171,556,243 lekë, pra konstatohet se e njëjta llogari ndryshon mes dy pasqyrave. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu, paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5.

- Llogaria 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 75,183,952 lekë, ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto pasqyrohet në shumën -45,212,625 lekë, pra **konstatohet** se e njëjta llogari ndryshon mes dy pasqyrave. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare, jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5.

- Llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 0 lekë.

- Llogaria 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 0 lekë.

- Llogaria 115 “Nga fondet e veta te investimeve” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 0 lekë.

Nga auditimi **konstatohet** se, mbyllja me tepricë 0 lekë e llogarive të burimeve të financimit të investimeve ndërkohë që investimet në proces janë në shumën 317,234,107 lekë është në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar paragrafi 1.1.2. Funksionimi për llogaritë e granteve kapitale të brendshme (llogaria 105) dhe të granteve kapitale të huaja (llogaria 106).

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5

2. Pasqyra e Performancës

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se, konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i “Të Ardhurave” në Pasqyrën e Performancës është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2024 pasqyra paraqitet si më poshtë:

- a- Të ardhurat (grupi A) = 255,069,838 lekë
- b- Shpenzimet (grupi B) = 179,885,886 lekë
- c- Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 75,183,952 lekë

Llogaria 85 “Teprica ose deficieti i periudhës“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Ndryshimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 në Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2023 me 31.12.2024, përkatësisht 13,037,740 minus 13,804,999 konstatohet -767,259 lekë. Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Pasqyra performancës financiare”.

2.1 Të ardhurat

Në kuptim të SKK1 Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e detyrimeve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike.

Të ardhurat janë flukse hyrëse parash dhe përfaqësojnë rritjet e përfitimeve ekonomike bruto gjatë ushtrimit kontabël (periudhës së raportimit). Burim kryesor për të ardhurat në sektorin publik janë nga aktiviteti buxhetor, mallrat e shërbimet (veçori për sektorin publik). Gjithashtu, burime të tjera janë interesat, dividendët, grantet. Të ardhurat rrisin përfitimet ekonomike në formën e rritjes së aktiveve dhe pakësimit të pasiveve (detyrimeve), të cilat kanë për rezultat shtimin e fondeve të veta.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas rakordimit me Degën e Thesarit, Gjyrokastër paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Emërtimi	Fakti	Plani	Fakti	Realizimi	
		i vitit 2023	i vitit 2024	i vitit 2024	Në vlerë	Në %
		1	4	5	6	
I	Të ardhurat nga taksat (I/a + I/b)					
I/a	Vendore (1-6)	17,355,182	5,173,872	3,316,518	3,316,518	
1	Taksa mbi pasurinë					
1.1	Taksa mbi ndërtesat	4,699,740	2,038,078	1,527,903	1,527,903	75%
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	7,711,997	2,016,881	1,380,435	1,380,435	68%
1.3	Taksa mbi truallin	595,254	318,913	255,295	255,295	80%
2	Takse e biznesit te vogel	4,348,191				
3	Taksa e ndikimit infrastrukturës nga ndërtimet e reja		800,000	152,885	152,885	19%
4	Taksa e tabelës dhe reklamës					
5	Taksa e fjetjes në hotele					
6	Taksa të tjera të përkohshme					
	- Për infrastrukturën në arsim					
	- Për shtresat në nevojë					
I/b	E Ndara (1-5)	-	3,600,000	4,951,341	4,951,341	
1	Taksa e kalimit drejtës pronësisë P.Paluaajtshme					
2	Taksa vjetore e qarkullimit mjeteve përdorura		2,200,000	2,948,538	2,948,538	134%
3	Taksa per lejen dhe tregtimin e karburan		200,000	200,000	200,000	100%
4	Tatimi mbi të ardhurat personale		1,200,000	1,802,803	1,802,803	150%
5	Taksa të tjera					
II	Të Ardhurat Jotatimore (II/a + II/b + II/c)					
II/a	Të ardhurat nga tarifat vendore	5,384,790	3,260,350	2,724,549	2,724,549	
1	Tarifa e pastrimit & largimit mbetjeve	2,277,850	1,594,500	1,331,050	1,331,050	83%
2	Tarifë ndicimi publik	1,228,320	516,850	410,460	410,460	79%
3	Tarifë gjelbërimi					
4	Tarifë per kullotat		500,000	663,159	663,159	133%
5	Tarifa të tjera (licence, leje, autorizime etj.)					
6	Tarifë parkimi					
7	Tarifë për kulturën					
8	Tarifë për hapësirat publike		31,000	25,080	25,080	81%
9	Të ardhura nga tarifat e Urbanistikës					
10	Tarifë për shërbimet e MZSH					
11	Tarifë leje transporti					
12	Të ardhura nga tarifa e lëndëve drusore					
13	Tarifa për shërbimet administrative		18,000	23,000	23,000	128%
14	Tarifa e shërbimit të ujtitjes dhe kullimit	1,461,400	600,000	271,800	271,800	45%

15	Pagesat nga Cerdhet					
16	Pagesat nga Kopshtet					
17	Pagesa nxënësve të Konviktit Shk. M. Profesionale					
18	Tarifa të tjera me vendim këshilli	417,220				
II/b	Të ardhura nga shitja e pronës, dhënia me qira	180,480	772,660	934,900	934,900	4.58
1	Shitje ndërtese banimi					
2	Shitje troje					
3	Shitje prona të tjera					
4	Qira mbi trojet		450,000	670,000	670,000	149%
5	Qira tokë bujqësore	180,480	317,860	253,900	253,900	80%
6	Qira mbi ndërtesat ,paisje etj.		4,800	11,000	11,000	229%
II/c	Të ardhura të tjera	2,864,223	50,000	470,066	470,066	0.00
1	Nga dhuratat jo tatimore		50,000	470,066	470,066	
2	Nga gjobat,kamata	2,864,223				
3	Të ardhura të tjera (debitore, ankande etj)					
GJITHSEJ TË ARDHURAT (I + II)		25,784,675	12,856,882	12,397,374	12,397,374	96%

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se, të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në shumën 12,397 mijë lekë, nga 12,856 mijë lekë të parashikuara, me mosrealizim në shumën 459 mijë lekë, ose realizuar në masën 96%. Krahasuar me vitin e mëparshëm, ku të ardhurat janë realizuar në shumën 25,785 mijë lekë, për vitin ushtrimor 2024 janë realizuar më pak për shumën 13,378 mijë lekë, ose në masën 48% e realizimit të vitit të kaluar. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta si: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 19%, taksa mbi tokën bujqësore në masën 68%, taksa mbi truallin në masën 80%, taksa mbi ndërtesat në masën 75%, tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit në masën 45%, Tarifë për hapësirat publike në masën 81%.

Ndërsa, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin në masa të konsiderueshme si: tarifat nga pyjet dhe kullotat në masën 132%, qira nga trojet në masën 148% taksa e tabelës në masën 115%, tarifa për shërbimet administrative në masën 134% Taksa vjetore e qarkullimit mjeteve përdorura në masën 127%, tatimi mbi të ardhurat personale në masën 150%. Këto fakte tregojnë se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është bërë mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu, për disa zëra të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/a, dhe 6.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës konstatohet se të ardhurat e realizuara gjatë vitit janë rezultat i të ardhurave nga taksat dhe tatimet në shumën 7,245,817 lekë, të ardhurave jotatimore në shumën 3,689,274 lekë granteve korrente në shumën 244,902,006 lekë, si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve në shumën -767,259 lekë të pasqyruara në tabelën nr. 16 në aneks:

Të ardhurat nga taksat dhe tatimet në shumën 7,245,817 lekë janë rezultat i të ardhurave të krijuara nga ana e Bashkisë Libohovë nga tatimi mbi të ardhurat e biznesit të vogël në shumën në shumën 493,615 lekë, tatimi mbi pasurinë e paluajtshme në shumën 4,607,375 lekë si dhe taksa vendore mbi përdorimin e mallrave dhe lejimit të veprimtarive në shumën 2,144,827 lekë.

Të ardhurat jotatimore në shumën 3,689,274 lekë përbëhen nga të ardhura të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia në shumën 957,100 lekë, të ardhura nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare në shumën 2,419,044 lekë si dhe të ardhura të tjera jotatimore në shumën 313,130 lekë.

- Të ardhurat të hyra në llogarinë e Bashkisë sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

r							Në lekë	
Institucioni	Të ardhura nga buxheti i shtetit	Të ardhurat e veta	Të ardhurat nga grantet dhe kreditë si burim financ për shp./investime	Të ardhura të tjera që janë planifikuar/ realizuar nga subjekti	Totali i të ardhurave			
	Fakt	Realizim	Fakt	Fakt	Fakt			

1	Bashkia Libohovë	169,345,770	15,686,432	-	-	185,032,202
				Nga këto:		
1.1	Trans Pakushtëz	58,239,566				58,239,566
1.2	Trans Sektorial	56,952,644				56,952,644
1.3	Transf e Kushtëzu					-
1.4	Fonde SASPAK					-
1.5	Të ardhura Vendo		15,686,432			15,686,432
1.6	Fonde për Termeti					-
1.7	Të Trasheg 2023	54,153,560				54,153,560
1.7.1	Transf Pakushtëzu	3,696,970				3,696,970
1.7.2	Transfjertë Sektor	34,755,348				34,755,348
1.7.3	Të ardhura Vendo	15,701,242				15,701,242
1.7.4	Fonde për Rindërt					-

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Grantet korrente përbëhen nga financimet nga buxheti:

- Llogaria 7200 “Nga buxheti për NJQP (Qendrore)” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 115,192,207 lekë,
- Llogaria 7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 36,499,189 lekë,
- Llogaria 7202 “Nga buxheti për pagesa të posaçme të ISSH” në shumën 34,305,710 lekë përfaqëson grantet për personat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara ,
- Llogaria 7204 “Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale” në shumën 4,751,341 lekë
- Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në shumën 0 lekë. Financim i pritshëm nga buxheti përfaqëson shumën që institucioni ka për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme. Mbyllja me tepicë në shumën 0 lekë e kësaj llogarie është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar “Llogaritë e Marrëdhënive me shtetin”.

- Llogaria 7209 “Të tjera grante korrente të brendshme” në shumën 54,153,560 lekë përfaqëson të ardhura të trashëguara nga vitit 2023. Këto të ardhura janë kontabilizuar një herë në pasqyrat financiare të vitit 2023. Kontabilizimi i tyre edhe në pasqyrat financiare të vitit 2024 sjell një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të të ardhurave të vitit 2024. **Konstatohet** se kontabilizimi i të ardhurave të vitit 2023 edhe në pasqyrat financiare të vitit 2024 është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar “*Rubrika 2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik*”

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pasqyrës së rezultatit të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

- Llogaria 73 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit të Produkteve” në shumën -767,259 lekë ka ndikuar totalin e të ardhurave të realizuara. Kjo shumë i korrespondon ndryshimit të gjendjes së mallrave llogarisë 63 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit”. Konstatohet se, kontabilizimi i kësaj shume në pasqyrën e rezultatit është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pasqyrës së rezultatit të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka

gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5.

2.2 Shpenzimet

Shpenzimet përfaqësojnë pakësim të përfitimeve ekonomike gjatë ushtrimit kontabël, në formën e daljes apo të pakësimit të vlerave të aktiveve apo rritjen e detyrimeve. Shpenzimet janë flukse dalëse gjatë periudhës raportuese, që kanë për rezultat zvogëlimin e kapitaleve të veta (fondeve), përfaqësojnë investimin që kryen njësia e qeverisjes së përgjithshme për realizimin e synimeve të tij të funksionimit gjatë një viti ushtrimor. Ato njihen në të njëjtën periudhë ushtrimore. Shpenzimet e raportuara pasqyrohen në tabelën nr. 17 në aneks:

Buxheti vjetor i vitit 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Gjirokastrë.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024 sipas akordimit të burimeve të financimit dhe llogarive ekonomike të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Libohovë	Te ardhura nga buxheti						Te ardhurat e veta (Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore)		Total te ardhurat	
	Transferta pakushtëzuar		Transferta e pakushtëzuar sektoriale		Transferta e kushtëzuar					
Akordimi I te Ardhurave (te trashëguara + viti ushtrimor)	61,936,536	-	91,707,992	-	70,804,895	-	31,387,674	-	255,837,097	
a- Te trashëguara	3,696,970		34,755,348				15,701,242		54,153,560	
b- Te viti	58,239,566		56,952,644		70,804,895		15,686,432		201,683,537	
Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Shpenzime për paga (600)	33,166,272	31,665,465	37,529,469	30,471,612	1,294,000	1,247,244	4,173,000	1,131,664	76,162,741	64,515,985
Shp për sig shoqërore/shëndetësore (601)	5,564,000	5,203,294	6,541,743	5,106,211	217,000	207,176	664,000	229,323	12,986,743	10,746,005
Shpenzime operative dhe shërbime (602)	28,045,472	19,329,681	30,174,679	7,497,067			10,369,692	3,249,167	68,589,843	30,075,915
Transferta tek organizatat (604)							730,000	100,373	730,000	100,373
Transferta tek individët (606)	80,000	68,000	84,500	71,825	36,345,000	34,305,706			36,509,500	34,445,531
Fondi rezervë + kontigjencës (609)	-	-	-	-	1,019,770	320,005	3,980,000	915,000	4,999,770	1,235,005
Shpenzime për investime (230)	-	-	-	-			774,971	-	774,971	-
Shpenzime për investime (231)	5,331,418	621,324	7,826,652	3,484,680	39,292,534	34,724,764	7,167,578	703,560	59,618,182	39,534,328
Total	72,187,162	56,887,764	82,157,043	46,631,396	78,168,304	70,804,895	27,859,241	6,329,086	260,371,750	180,653,142

Niveli i realizimit të buxhetit vjetor 2024 referuar akt-rakordimit me thesarin sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Artikulli buxhetor	Shpenzimet për vitin 2024		
	Plan përfundimtar	Fakt	% e Realizimit
Shpenzime për paga (600)	76,162,741	64,415,185	84.58
Transferta e pakushtëzuar	33,166,272	31,665,465	95.47
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	37,529,469	30,471,612	81.19
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	4,173,000	1,131,664	27.12
Transferta e kushtëzuar	1,294,000	1,146,444	88.60
Shp për sig shoqërore/shëndetësore (601)	12,986,743	10,746,005	82.75
Transferta e pakushtëzuar	5,564,000	5,203,294	93.52
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	6,541,743	5,106,211	78.06
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	664,000	229,323	34.54
Transferta e kushtëzuar	217,000	207,176	95.47
Shpenzime operative dhe shërbime (602)	68,589,843	30,075,915	43.85
Transferta e pakushtëzuar	28,045,472	19,329,681	68.92
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	30,174,679	7,497,067	24.85
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	10,369,692	3,249,167	31.33
Sponsorizime			
Transferta e kushtëzuar			
Fonde për Rindërtimin			
Subvencione (603)	-	-	
Transferta e pakushtëzuar			
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore			
Transferta tek organizatat (604)	730,000	100,373	13.75
Transferta e pakushtëzuar			
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	730,000	100,373	13.75
Transferta e kushtëzuar			
Fonde për Rindërtimin			
Transferta tek individët (606)	38,529,270	35,781,336	92.87

Transferta specifike	1,019,770	320,005	31.38
Transferta e pakushtëzuar	80,000	68,000	85.00
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	84,500	71,825	85.00
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	1,000,000	915,000	91.50
Transferta e kushtëzuar	36,345,000	34,406,505	94.67
Fonde për Rindërtimin			
Fondi rezervë + kontigjencës (609)	2,980,000	-	-
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	2,980,000	-	-
Hartim projektesh dhe oponenca teknike (230)	774,971	-	-
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	774,971	-	-
Transferta e pakushtëzuar			
Transferta e pakushtëzuar sektoriale			
Fonde për Rindërtimin			
Shpenzime për investime (231)	59,618,182	39,534,328	66.31
Transferta e pakushtëzuar	5,331,418	621,324	11.65
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	7,826,652	3,484,680	44.52
Të ardhurat nga taksat dhe tarifaf vendore	7,167,578	703,560	9.82
Sponsorizime			
Transferta e kushtëzuar	39,292,534	34,724,764	88.37
Fonde për Rindërtimin			
Shpenzime Principali (166)	-	-	-
Transferta e pakushtëzuar			
Shpenzime Interesi (651)	-	-	-
Transferta e pakushtëzuar			
TOTALI	260,371,750	180,653,141	69.38

Burimi: Sektori i Financës, Bashkia Libohovë

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2024 rezulton në masën 69.4%, pra në nivele mjaft të ulta, ku fondet buxhetore janë realizuar në shumën 180,653 mijë lekë nga buxheti i planifikuar në shumën 260,372 mijë lekë. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar:

- Mosrealizimi i fondeve në llogaritë e shpenzimeve korente, kryesisht në llogarinë 602 “Shpenzime për mallra dhe shërbime” në masën 43.8%, llogaria 600 “Shpenzime për paga dhe llogaria 601 “Shpenzime për sig shoqërore/shëndetësore” përkatësisht në masën 84.6% dhe 82.7%, të cilat tregojnë për parashikim përtej nevojave dhe një planifikim jo të saktë të këtyre shpenzimeve.
- Llogaria 231 “Shpenzimet për investime” e realizuar në masën 66.3%, ku investimet janë përballuar kryesisht me burime nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transferta e kushtëzuar. Investimet me burim financimi të ardhurat e veta janë realizuar në masën 9.8%, nivel ky mjaft i ulët, pavarësisht nga të fondet e trashëguara, kjo për arsye se një pjesë e investimeve janë prokuruar në fund të vitit 2024, duke mos u financuar ose financuar pjesërisht gjatë vitit 2024.

Mbi të ardhurat e trashëguara

Emërtimi	Në lekë				
	Të ardhurat e trashëguara të vitit paraardhës 2023	Të ardhurat e vitit 2024	Të ardhurat nga Fondi i Rindërtimit	Shpenzimet e vitit 2024	Te ardhura që mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 2025
Bashkia Libohove	54,153,560	130,878,642		109,848,246	75,183,956
Nga këto:					
-Transf.Pakushtëzuar	3,696,970	58,239,566		56,887,764	5,048,771
-Transf.Sektoriale	34,755,348	56,952,644		46,631,396	45,076,597
-Të Ardhura Vendore	15,701,242	15,686,432		6,329,086	25,058,588
-Fonde për Rindërtimin					

Referuar të dhënave të të ardhurave të trashëguara rezulton se, Bashkia Libohovë ka patur fonde në dispozicion për rritjen e performancës së realizimit të investimeve dhe nuk ka argumente justifikues për realizimin në nivele aq të ulët të fondeve për investime, përveç mungesës së kapaciteteve dhe punës së pa mjaftueshme për vënien në eficiencë të fondeve brenda vitit ushtrimor dhe rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon.

Buxheti i detajuar sipas burimeve të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Transferta	Fakt 2024	Pesha specifike ne totalin e shpenzimeve faktike
Transferta e pakushtëzuar	56,887,764	31%

Transferta e pakushtëzuar sektoriale	46,631,396	26%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	6,329,086	4%
Transferta e kushtëzuar	70,804,895	39%
Totali	180,653,142	100%

Referuar të dhënave për vitin 2024 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 6,329 mijë lekë, ose në masën 4 %, nga transferta e pakushtëzuar në shumën 56,888 mijë lekë, ose në masën 31 %, transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 46,631 mijë lekë, ose në masën 26 %, transferta e kushtëzuar në shumën 70,805 mijë lekë, ose në masën 39%.

Vështirësia financiare

Në lekë

Nr	Bashkia Libohovë	Transferrat e pakushtëzuar + ardhurat vendore	Fondet e kushtëzuara	Stoku i detyrimeve të prapambetura	Statusi i gjendjes financiare i raportuar	Te ardhurat e paperdorura për	Shpenzimet e realizuara për	Shpenzimet e miratuara për
						vitin 2024	vitin 2024	vitin 2024
Bashkia Libohovë (1+2)		185,032,202	70,804,895	6,832,410		75,183,956	180,653,142	260,371,750
1	Fondet e Bashkisë	185,032,202	0	6,832,410	6.22%	75,183,956	109,848,246	182,203,446
1.1	Burimet e veta	185,032,202	0	6,832,410		75,183,956	109,848,246	182,203,446
-	Transferta e pakushtëzuar	61,936,536		6,832,410		5,048,771	56,887,764	72,187,162
-	Transferta sektoriale	91,707,992				45,076,597	46,631,396	82,157,043
-	Të ardhurat vendore	31,387,674				25,058,588	6,329,086	27,859,241
1.2	Fonde për Rindërtimin							
2	Fondet e Kushtëzuara	0	70,804,895				70,804,895	78,168,304

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2024 paraqiten në vlerën 6,832,410 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 6.22 % kundrejt shpenzimeve faktike. Kjo situatë tregon se Bashkia Libohovë konsiderohet në situatë normale të gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% në fund të vitit ushtrimor, duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33. Nga Bashkia Libohovë është kryer raportimi i detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financës.

Raportet e monitorimit.

Për vitin 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit. **Për vitin 2024** janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:

- Raporti 4-mujor, është miratuar me VKB-ne nr.27 date 23.05.2024, i cili është dërguar ne Ministri me shkresën nr.1101 date 29.05.2024 dhe me e-mail ne datën 30.05.2024.
- Raporti 8-mujor, është miratuar me VKB nr.48 date 22.09.2025, i dërguar ne Ministri me shkresën nr. 1859/1 date 30.09.2024 dhe e-mail date 23.09.2024
- Raporti 12-mujor, është miratuar me VKB nr. 09 date 21.02.2025, i dërguar ne Ministri me shkresën nr. 398 date 27.02.2025 dhe e-mail date 28.02.2025.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se në to janë pasqyruar saktë treguesit e realizimit të buxhetit referuar dhe akt akordimit me degën e thesarit. Po kështu këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë.

Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë ushtrimore dhe paraqiten në tabelën nr. 15 në aneks. Analiza e shpenzimeve sipas Formatit 2 “Pasqyra e performancës” në pasqyrat financiare, si më poshtë:

- Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në shumën 64,415,185 lekë përfaqëson pagat e personelit të përhershëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts. Nga auditimi shpenzimeve për paga konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit për këtë zë, duke sjellë një pasqyrim të saktë të shpenzimeve për paga.

- Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve” në shumën 10,746,002 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts. Nga auditimi shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit.

- Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në shumën 30,075,915 lekë, përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve, konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit.

Për vitin 2024 shpenzimet për mallra dhe shërbime janë klasifikuar sipas nënllogarive të klasës 602 si më poshtë:

Llogaria 6020 “Materiale zyre e të përgjithshme” në shumën 1,729,440 lekë, përfaqëson shpenzime për materiale kancelari, si dhe shpenzime për materiale ndriçimi rrugor. Nga auditimi i llogarisë analitike konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike, por shpenzimet për materiale ndriçimi rrugor në shumën 1,066,320 lekë janë keqklasifikuar në këtë llogari. Kontabilizimi në këtë llogari sjell denatyrin të shpenzimeve, për rrjedhojë një paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve të periudhës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Nga auditimi i llogarisë 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” në shumën 2,604,615 lekë në pasqyrën e performancës, konstatohet se rakordon me llogarinë analitike.

Nga auditimi i llogarisë 6022 “Shërbime nga të tretë” në shumën 7,763,610 lekë në pasqyrën e performancës, konstatohet se rakordon me llogarinë analitike.

Nga auditimi i llogarisë 6023 “Shpenzime transporti” në shumën 3,730,943 në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë analitike.

Nga auditimi i llogarisë 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 658,680 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë analitike.

Nga auditimi i llogarisë 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në shumën 4,822,502 lekë përfaqëson shpenzime për vendimet gjyqësore dhe konstatohet se rakordon me llogarinë analitike.

Nga auditimi i llogarisë 6029 “Shpenzime të tjera operative” në shumën 8,457,684 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë analitike. Nga auditimi i llogarisë analitike **konstatohet** shpenzime për vendime gjyqësore në shumën 1,898,092 lekë të cilat janë keqklasifikuar në këtë llogari. Kontabilizimi në këtë llogari sjell denatyrin të shpenzimeve e për rrjedhojë një paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve të periudhës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

- Llogaria 6044 “Transferime korrente tek organizatat jofitimprurëse” në shumën prej 1,335,378 lekë përfaqëson përgjithësisht transferta dhe shpenzimet për ndihmën ekonomike

- Llogaria 6061 “Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor” në shumën prej 34,546,337 lekë përfaqëson pagesa për ndihmën ekonomike dhe invaliditetin

- Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruar drejtë në shumën prej -767,259 lekë.

Seksioni i “Shpenzime të tjera” përfaqëson operacionet e korigjimit të rezultatit që evidentohen në pasqyrën e shpenzimeve të funksionimit.

Nga auditimi **konstatohet** se në pasqyrën e rezultatit janë përfshirë operacione të korigjimit të rezultatit në shumën 39,534,328 lekë të cilat nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të tilla, sepse

kjo vlerë përbëhet nga transaksione për investime të financuara nga fondet buxhetore dhe jo nga fondet e veta. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pasqyrës së rezultatit të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5.

3. Pasqyra e flukseve monetare (cash flow)

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentët e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme.

Nga auditimi konstatohet se akordimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente në pasqyrën e flukseve monetare është shumën 91,368,351 lekë, arkëtime e të hyra Cash gjatë vitit në shumën 55,280,008 lekë. Pagesa për detyrime e shpenzime korente gjatë vitit ushtrimor janë bërë 156,800,345 lekë. Nga veprimtaritë e investimeve akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale në shumën 59,618,190 lekë ndërsa pagesat për detyrime e investime të vitit ushtrimor janë në shumën 39,534,328 lekë. Në transfertat e tjera janë kontabilizuar transferime në buxhet të fondeve të përdorura në shumën 2,795,635 lekë.

Teprica e mjeteve monetare në fund të periudhës ushtrimore është 85,215,303 lekë, e cila kuadron me gjendjen e disponibiliteteve në pasqyrën e pozicionit financiar, nga të cilat 10,031,351 lekë janë fonde të ngurtësuara lidhur me garancitë e kontratave.

Mbi të ardhurat e trashëguara:

Subjekti	Te ardhurat e trashëguara të vitit paraardhës	Te ardhurat e vitit	Te ardhurat nga fondi i rindërtimit	Shpenzimet e vitit	Te ardhura që mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës
Bashkia Libohove	54,153,432	130,878,638	-	109,848,246	75,183,824

4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto

Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor të mbyllur raportues.

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë vetëm për totalin e fondeve neto me pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C. **Konstatohet** se në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet të dhënat e paraqitura nuk rakordojnë me të dhënat e llogarive kontabël për të dhënë ndryshimet që kanë pësuar gjatë periudhës kontabël fondet neto. Nga auditimi **konstatohet** se llogaria 105 “Nga grantet e brendshme kapitale(+)” çelet me tepricë në shumën 49,372,444 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar çelet me tepricë 0 lekë. Në mbyllje të vitit ushtrimor mbyllet me tepricë në shumën 49,372,444 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar mbyllet me tepricë në shumën 0 lekë.

Nga auditimi **konstatohet** se llogaria 12 “Nga Rezultatet e mbartura(+,-)” çelet me tepricë në shumën 117,402,683 lekë, shtohet gjatë vitit në shumën 54,153,560 lekë dhe mbyllet në shumën 171,556,243 lekë. Ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar çelet me tepricë 44,312,956 lekë dhe mbyllet me tepricë në shumën 54,153,560 lekë.

Nga auditimi **konstatohet** se llogaria 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)” çelet me tepricë në shumën 29,971,327 lekë, pakësohet gjatë vitit në shumën 75,183,952 lekë dhe mbyllet në shumën -45,212,625 lekë. Ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar çelet me tepricë 54,153,560 lekë dhe mbyllet me tepricë në shumën 75,183,952 lekë.

Nga auditimi **konstatohet** se llogaria 106 “Nga grantet e jashtme kapitale (+)” çelet me tepricë në shumën 9,548,000 lekë dhe mbyllet në shumën 9,548,041 lekë. Ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar çelet me tepricë 0 lekë dhe mbyllet me tepricë në shumën 0 lekë.

Nga auditimi **konstatohet** se llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ (-)” nuk ka të kontabilizuar asnjë transaksion lidhur me vlerën e amortizimit të aktiveve afatgjata gjatë vitit ushtrimor.

Llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ” në pasqyrën e pozicionit financiar është pjesë e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i Akumuluar)” sipas vlerës së paraqitur në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto.

Llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ” në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto është rezultat i Pasqyrës së Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto) sipas normave të amortizimit të aplikuara nga subjekti. Aplikimi i normave jo të sakta të amortizimit të trajtuara në seksionin e aktiveve ndikon rezultatin e llogarisë 1013 “Nga konsumi i AAGJ”, i cili nga ana e tij ndikon llogarinë 101 “Teprica (Fondi i Akumuluar)”.

Në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” amortizimi është përlllogaritur në shumën 23,316,898 lekë. Kjo shumë nuk është transferuar në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto në mënyrë që të ndikojë në totalin e fondeve neto dhe të kemi një pasqyrim të plotë dhe të saktë të fondeve neto.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.

Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovitimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

5. Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit.

Nga auditimi i pasqyrës se investimeve dhe burimeve të investimeve konstatohet se kjo pasqyrë statistikore nuk është e plotësuar në mënyrë të saktë, në mënyrë që të japë një pasqyrim të plotë të të gjitha transaksioneve që kanë ndodhur gjatë vitit lidhur me burimet e financimit dhe investimet të pasqyruara në tabelën nr. 18 në aneks.

Nga auditimi **konstatohet** se në çelje të vitit ushtrimor veprimet kontabël në kredi të llogarive të burimeve për investime nuk rakordojnë me veprimet në debi të llogarive të shpenzimeve për investime. Teprica në fillim të vitit për shpenzime për aktive afatgjata materiale është 317,234,107 lekë, ndërsa teprica në fillim të vitit e burimeve për investime është 0 lekë.

Nga auditimi **konstatohet** se, në transaksionet e vitit veprimet në kredi të shpenzimeve për investime nuk është e saktë sepse jo të gjitha investimet në shumën 39,543,328 lekë kanë përfunduar. Janë konstatuar investime në shumën 34,987,528 lekë të cilat nuk kanë përfunduar akoma, pra që janë në proces, ndërkohë që nga subjekti janë kontabilizuar si të përfunduara. Rrjedhimisht teprica në fund të vitit për shpenzime për investime nuk është e saktë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar. Efekti në

pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

Nga auditimi **konstatohet** se në çelje të vitit ushtrimor llogaria 12 “Rezultat i mbartur” në shumën 44,312,956 është klasifikuar si burim për investimeve. Nga transaksionet e vitit nuk kemi asnjë transaksion të kontabilizuar për të kuptuar se si gjendja e kësaj llogarie u mbyll në fund të vitit në shumën 54,153,560 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar. Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu, paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 5.

Gjithashtu, nga auditimi **konstatohet** se pasqyra e nuk është e saktë në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar paragrafi 3.8 “Rregullat për plotësimin e pasqyrave statistikore që shoqërojnë pasqyrat financiare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme”. Duke qenë se pasqyra nuk është e plotësuar dhe hartuar në mënyrë të saktë konstatohen diferenca në llogaritë e burimeve të financimit konkretisht në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”.

Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu, paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5. Të dhënat e pasqyrës së Investimeve dhe Burimeve të Financimit raportuar nga subjekti në pasqyrat financiare janë paraqitur në tabelën nr. 18 në aneks:

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon: Nga auditimi u konstatua se Bashkinë Libohovë ka të dhëna mbi vlerën kontabël të aktiveve në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë i aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, është audituar periudha 2024.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, konstatohet se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, që përcakton se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Konstatohet se regjistri i aktiveve nuk është hartuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Inventarizimi i vitit 2024:

Me Urdhrin e Kryetarit nr. 206 datë 12.12.2023 është urdhëruar “Ngritja e komisionit të inventarizimit fizik dhe vlerësimit për vitin 2024” me përbërje A. Dh., S. T., K. G., A. Ç. dhe G. Ç. Afati i inventarizimit do të jetë 15.12.2024 – 31.12.2024 për të gjitha objektet e inventarit.

Me Urdhrin e Kryetarit nr. 207 datë 12.12.2023 është urdhëruar “Ngritja e komisionit të nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve për vitin 2024” me përbërje Xh. S., A. T., E. L., L. Sh. dhe F. Z.

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

Nga auditimi **konstatohet** se komisioni i inventarizimit është i njëjtë me atë të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 97 “*Në të gjitha rastet komisioni i vlerësimit të aktiveve ka përbërje tjetër nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi në njësi të aktiveve. Titullari mund të ngrejë një komision të vetëm për kryerjen e inventarizimit¹⁴ dhe vlerësimit të aktiveve.*”. Pika 99 “*Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës si dhe specialistë të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit*”.

U **konstatua** se, anëtarë të komisionit të inventarizimit janë edhe dy punonjës të sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, të MF, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 82, ku citohet se: “*Komisioni nuk duhet të jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi ...*” si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22 “*veprimtaria e kontrollit*”, pika 3. b “*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin*”.

U konstatua se, nga ana e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve është përpiluar vetëm një procesverbal i firmosur nga komisioni, i cili thekson se: “Nga verifikimi fizik i materialeve të zyrave të Bashkisë, institucioneve arsimore dhe kryesive të fshatrave u gjetën materiale, të cilat ishin jashtë funksionit (lista bashkëlidhur)”. Bashkëlidhur këtij procesverballi është lista me asetet, të inventarizuara si jashtë funksioni. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011

“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 85 “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit...

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.”

U **konstatua** se nga ana e komisionit të vlerësimit nuk janë zbatuar dispozitat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 103 – 106.

U konstatua se regjistri i aktiveve i nuk është i plotësuar në formën e kërkuar nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar pika nr. 30 “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Bashkisë Libohovë përveç pasurive të paluajtshme (aktive) të vlerësuara të paraqitura në PF, i janë transferuar listat përfundimtare të inventarëve me VKM përkatëse të gjitha pasuritë e paluajtshme që shtrihen në territorin nën juridiksionin e bashkisë, ku numri dhe statusi i tyre sipas njësive administrative paraqiten në tabelën e mëposhtme.

U **konstatua** se nuk është bërë inventarizimi dhe kontabilizimi i pronave të paluajtshme sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 415 datë 11.07.2007, vendimit nr. 272 datë 21.04.2010, vendimit nr. 706, datë 11.07.2007 si dhe vendimit nr. 398, date 13.05.2020. të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë sipas tabelës së mëposhtme:

Bashkia	Nj. A	VKM	Sasia	Certifikuar	Inventarizuar	Vlerësuar	Kontabilizuar	Prona të zaptuara	Prona në proces legalizimi	te tjera që mund të shtohen sipas llojit
Libohove	Qyteti Libohove	VKM 415 dt 11.07.2007	203	3 (tre). Nr.pas.2/27, 8/436, 14/150		-	-	Nuk ka	Nuk ka	
	Nj.A. Qender Libohove	Vendim Nr.272. Dt. 21.04.2010	867			-	-	Nuk ka	Nuk ka	
	Nj.A. Zagorie	Vendimi. Nr.706. Dt.12.10.2011	547	4(kater). Nr. Pas.14/8 Nivan; 20/2 Komuna Zagorie; 213/2 Hoshteve; 610 Sheper.		-	-	Nuk ka	Nuk ka	
	Qyteti Libohove, Nj.A. Qender Libohove, Nj.A. Zagorie	VKM NR 398 date 13.05.2020 PYJEVE DHE KULLOTA	76	-			-	Nuk ka	Nuk ka	

Pronat sipas njësive administrative, llojit dhe sipërfaqeve paraqiten si më poshtë:

në lekë

Tabela Përmbledhëse E Pasurive - Bashkia Libohove - Sipërfaqet														
Nr.	Emërtimi	Truall	Are	Vresht	Pemëtore	Vaditës e	Kullues e	Përrenj	Rezervu are	Rruge	Kull ote	Pyje	Nat yre	Objekte
	Njësia	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	m ²	ha	ha	ha	m ²
I	Libohove	94,902	297,000	4,309,700	4,000,000	247,400	204,600	8,300	2,450,000	366,716	559.5			7,827

II	Njësi Administrative Qendër Libohovë	395133	3,069,936	42,400	9,069,308	269,469	385,400	2,076,422	117,000	521,684				40,966
III	Njësi Administrative Zagorie	116,288	415,000	9,126,500		135,600		2,314,391		411,632	2,642	2,276	784	6377
	Shuma	606,323	3,781,936	13,478,600	13,069,308	652,469	590,000	4,399,113	2,567,000	1,300,032	3,202	2,276	784	55,170

Burimi: Pasqyra Financiare Bashkia Libohovë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e ndjekura për hipotekimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të listave përfundimtare të formularëve të inventarit të transferuara me VKM nga pushteti qendror u konstatua se, Bashkisë Libohovë i janë transferuar në përdorim/pronësi 1693 asete, nga të cilat ka të regjistruara dhe pajisur me certifikatë vetëm 7 asete, rrjedhimisht dhe të inventarizuara. Për pjesën tjetër të pasurive të pa luajtshme dhe parcelat nga fondi pyjor/kullor nuk është kryer përditësimi i inventarit dhe nuk janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre, për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në DVASHK Gjirokastër.

Gjithashtu, nuk ka vlerësim të pasurive të paluajtshme si ato të certifikuara dhe ato të pa certifikuara, duke mos i evidentuar si aktive në PF, me ndikim në pasqyrimin e gjendjes reale të pasurisë së kësaj njësie vendore.

2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Libohovë, nga KLSH me shkresën nr. 435/9prot., datë 31.07.2024, bërë hyrje në Bashkinë Libohovë me shkresën nr. 678/15prot., datë 05.08.2024, për periudhën e auditimit 01.01.2023-31.12.2023, janë marrë masa dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht:

Në zbatim të nenit 15, shkronja j, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.01.2014’ Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Libohovë është hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së. Plan Veprimi ka përfshirë të gjitha masat organizative, masat për shpërbllim dëmi, masat për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve, masat administrative dhe masat disiplinore të renditura sipas nivelit të riskut. Janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohorë të përcaktuar referuar urdhrin nr. 678/16prot., datë 07.08.2024 të Kryetarit të Bashkisë Libohovë “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar”. Plan Veprimi u është dërguar Këshillit Bashkiak dhe strukturave përgjegjëse, Drejtori, Ndërmarrje, Inspektorate e Sektorë që të bëjnë analizë të punës së tyre, me qëllim përmirësimin e punëve në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Një kopje e Plan Veprimit i është dërguar dhe KLSH-së, me shkresën nr. 678/18, datë 30.08.2024, **brenda 20 ditëve** nga marrja e Rekomandimeve.

Me shkresën nr.678/1, datë 30.01.2025 Bashkia Libohovë, bazuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka dërguar në KLSH zbatimin e Plan Veprimit dhe raportimin për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, pra **brenda afatit 6 mujor** nga marrja njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe Rekomandimeve

Në zbatim të Rekomandimeve nga auditimi në Bashkinë Libohovë, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 435/9prot., datë 31.07.2024, në mënyrë përmbledhëse zbatimi i tyre është si më poshtë:

- Nga 37 masat e rekomanduara gjithsej, janë pranuar plotësisht të 37 masat dhe janë realizuar si më poshtë:

- Nga 20 masa organizative janë zbatuar 11 masa, janë në proces 2 masa, pjesërisht e zbatuar 1 masë, dy masa në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 7 masa organizative. Nga 20 masat organizative të dhëna gjithsej, 9 masa i përkasin auditimit të mëparshëm (periudha 01.01.2023 deri më 31.12.2023), nga të cilat janë zbatuar 7 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 2 rekomandime, përkatësisht

rekomandimi 1.1 dhe 5.1. Ndërsa 11 rekomandimet e tjera i takojnë periudhës së audituar 01.01.2021 deri më 31.12.2022 që rezultojnë të zbatuara 6, pjesërisht të zbatuara një masë, në proces zbatimi 2 masa dhe të pa zbatuara 6 masa. Këto rekomandime në thelb janë të njëjta me problematikat në formë dhe përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohen.

- Nga 2 masa për shpërblim dëmi ekonomik, janë pranuar plotësisht dhe rezultojnë të zbatuara.
- Nga 1 masë për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) është pranuar dhe rezulton pjesërisht e zbatuar.
- Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, janë pranuar dhe zbatuar të 2 masat.
- Nga 9 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, është zbatuar 1 masë, 2 masa në proces zbatimi, përkatësisht masat 6.2 dhe 7.1; të zbatuara pjesërisht 3 masa: masat 3.1, 4.1 dhe 5.2, ndërsa të pa zbatuara rezultojnë 3, përkatësisht masat 1.1, 2.1 dhe 5.1.
- Për 2 masa disiplinore “Vërejtje” për dy punonjës në marrëdhënie pune, rezulton se nga Kryetari i Bashkisë nuk janë dhënë, ndërsa masa “Vërejtje” për një ish punonjës rezulton e ezauruar, pra rezultojnë 3 masa të zbatuara.

Më hollësisht zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së paraqitet si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrimit të Riskut, (iii) të ngrihet struktura e koordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut, (iv) të garantohet se njoftimi/ shpallja e vendeve të lira të punës, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë nga subjekti për realizimin e këtij rekomandimi.
Statusi: Pazbatuar.

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Libohovë, të marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Pretendimi i subjektit: Me shkresën nr.759/1prot., datë 24.04.2025, Njësia e Auditit të Brendshëm ka dërguar në Bashkinë Libohovë, njoftimin për fillim auditimi, për realizimin e objektivave mbi funksionin e bashkisë, në drejtim të hartimit të buxhetit, veprimtarisë financiare të njësisë, prokurimet publike, të ardhurat, kullotat dhe tokat bujqësore, shërbimet publike, menaxhimin e burimeve njerëzore, policia bashkiake.

Statusi: Zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Libohovë.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipe të Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

- Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;
- Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;
- Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Libohovë.

Pretendimi i subjektit: Për PBA 2025-2027 është ndjekur gjithë procedura e saktë duke filluar që me ngritjen e GMS me urdhër nr.12, datë 16.01.2024, EMP, procesverbalet e mbajtura për secilën mbledhje të GMS dhe EMP, tavanet buxhetore, duke ndjekur çdo hap deri në fazën përfundimtare të PBA 2025-2027.

- 1.Procesverbali i mbajtur me datë 13.03.2024 për njohjen dhe ngritjen e urdhrit.
- 2.Procesverbali i mbajtur me datë 03.04.2024 për PBA.
3. Procesverbali i mbajtur me datë 02.05.2024 për plotësimin e të dhënave dhe miratimin në Këshillin Bashkiak të PBA-së.

Statusi: Zbatuar.

3.2.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raportet 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave.

Pretendimi i subjektit: Raportimet 4-mujore, 8-mujore, 12-mujore janë raportuar në Këshillin e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore si dhe janë dërguar elektronikisht dhe me shkresë zyrtare pranë Ministrisë së Financave brenda afateve të përcaktuara. Raportimi 4-mujor me shkresë nr. 1101prot., datë 29.05.2025, raportimi 8-mujor me shkresë nr. 1851/1prot., datë 30.09.2025, raportimi 12- mujor me shkresë nr. 328prot., datë 27.02.2025.

Statusi: Zbatuar.

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Pretendimi i subjektit: Detyrimet e prapambetura të rakorduara me Degën e Thesarit, tregojnë për një ulje të detyrimeve të prapambetura nga 13,754,912 lekë në 31.12.2023, në vlerën 6,832,410 lekë në fund të vitit 2024, pra likuiduar në vlerën 6,922,502 lekë. Pagesë në kohë të faturave dhe mos krijim i detyrimeve të reja të prapambetura për vitin 2024.

Nga auditimi mbi dokumentacionin dhe evidencat e vëna në dispozicion, konstatohet se gjatë vitit 2024 nuk janë krijuar detyrime të reja, bashkia ka shlyer detyrime të prapambetura, ndërsa për shumën e mbetur, e cila i takon detyrimeve për energjinë elektrike ka një plan shlyerje.

Statusi: Zbatuar.

4.2.Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Pretendimi i subjektit: Planifikimi i të ardhurave është bërë në bazë të dhënave që sjell secili sektor që gjeneron të ardhura, duke u bazuar në treguesit e paketës fiskale. Në vitin 2024 realizimi i të ardhurave ishte në 122% si arsye e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura, duke përdorur si strategji dhe faljen e kamatëvonesave, me VKB.

Statusi: Zbatuar.

5.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për identifikimin e vlerave të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues për llogaritë ekonomike si vijon:

-Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*”

-Llogaria 212 “*Ndërtime konstruksione*”.

-Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*”

Pretendimi i subjektit: Është ngritur një grup pune për analizën e bilanceve para bashkimit të NJA dhe nuk është gjetur ndonjë emërtim që të vërtetojë vlerat e pidentifikuara. Për këtë arsye këto vlera vazhdojnë të jenë në bilancet e institucionit si “Vlerë tjetër”

Statusi: Pazbatuar.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë Libohovë. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, etj., në pronësi të Bashkisë Libohovë, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në pasqyrat financiare.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë nga subjekti për realizimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pazbatuar.

7.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 të sistemojë vlerën **14,256,168** lekë me analizë në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*” me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerave në kontabilitet.

Pretendimi i subjektit: Në mbyllje të pasqyrave financiare vlera 14,265,168 lekë e lënë nga KLSH është pasqyruar tek llogaria 214 në mbyllje të pasqyrave financiare 2024.

Statusi: Zbatuar.

8.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rekomandimet nr. 1.1; 1.2; 4.1; 5.1.; 11.1; që i përkasin kategorisë masa organizative të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet përveç rekomandimit nr. 22.3.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrin masa që të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor. Për këtë të bëhet likuidimi i vlerës së kontratës të lidhur midis Bashkisë Libohovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Pretendimi i subjektit: Detyrimet e prapambetura të rakorduara me Degën e Thesarit, tregojnë për një ulje të detyrimeve të prapambetura nga 13,754,912 lekë në 31.12.2023, në vlerën 6,832,410 lekë në fund të vitit 2024, pra likuiduar në vlerën 6,922,502 lekë. Pagesë në kohë të faturave dhe moskrijim i detyrimeve të reja të prapambetura për vitin 2024.

Statusi: Zbatuar.

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, të vijoje punën për arritjen e një aktmarrëveshje me shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Libohovë” SH.A, me qëllim që kjo e fundit të kryhej rolin e agjentit tatimor, për taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë e taksapaguesve familjare. Për këtë të merret miratimin e Këshillit Bashkiak.

Pretendimi i subjektit: Këshilli Bashkiak ka marrë një vendim për lidhjen e Akt-marrëveshjes me Ujësjetllësin për caktimin e këtij të fundit si agjent tatimor. Vendim nr. 06, datë 24.01.2025. I është dërguar shkresa për lidhjen e akt-marrëveshjes Shoqërisë Ujësjetllës -Kanalizime Gjirokastër dhe akoma nuk ka ardhur asnjë përgjigje.

Statusi: Proces.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa që gjatë procesit të dhënies së ndërtesave me qira, të bëjë s’kualifikimin e të gjithë subjekteve konkurruese të cilët nuk vërtetojnë se plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga Bashkia Libohovë.

Pretendimi i subjektit: Nuk ka asnjë rast për dhënien me qira të ndërtesave.

Statusi: Zbatuar.

9.2.Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa që në hartimin e kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve, të përcaktojë se detyrimet për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe të ujit, janë të qiramarrësit. Të përcaktohet person apo strukturë për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave.

Pretendimi i subjektit: Nuk ka asnjë rast për dhënien me qira të ndërtesave. Në momentin që të lidhen kontrata do të zbatohet rekomandimi.

Statusi: Zbatuar.

10.1.Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të hartohet regjistri kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administron Bashkia Libohovë.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë akoma për realizimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pazbatuar.

10.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin në terren e të gjitha pronave që administron Bashkia Libohovë, për të përcaktuar dhe verifikuar situatën faktike, nëse ekzistojnë në teren të gjitha pronat ashtu si ato paraqiten në VKM përkatëse nëpërmjet të cilave janë transferuar në Bashkinë Libohovë. Në përfundim të procesit të inventarizimit të informohet Kryetari i Bashkisë për rezultatet e këtij procesi.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë akoma për realizimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pazbatuar.

10.3.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga strukturat përkatëse të përgatiten dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të të gjitha pronave që administron. Sektori i Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë akoma për realizimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pazbatuar.

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë të gjitha masat për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke respektuar kriteret e arsimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Pretendimi i subjektit: Me urdhër të kryetarit të bashkisë nr.115, datë 12.12.2022 është urdhëruar që punonjësi V.I të kalojë nga pozicioni punonjës social në sektorin e Kulturës në sektorin e Mbrojtjes së Territorit në bashkinë Libohovë, me kategorinë IV- a, niveli i diplomës Bachelor.

Statusi: Proces.

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 801/1prot., datë 19.12.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masat e duhura për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi për MFK, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

Pretendimi i subjektit: Është marrë masa e duhur për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi të MFK-së.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

6.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e riskut nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë nga ana e subjektit për realizimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pazbatuar.

8.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për hartimin e raporteve periodike 4 mujor të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe këto raporte ti paraqiten për njohje këshillit bashkiak, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pretendimi i subjektit: Raportimi 4-mujor me shkresë nr. 1101prot., datë 29.05.2025, raportimi 8-mujor me shkresë nr. 1851/1prot., datë 30.09.2025, raportimi 12- mujor me shkresë nr. 328prot., datë 27.02.2025.

Statusi: Zbatuar.

B.2. Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Nëpunësi Zbatues, të ndjekin të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës 76,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga paga e grupit, përkatësisht vlerës 36,000 leke nga z. L. B. dhe vlerës 40,000 lekë nga znj. E. L.

Pretendimi i subjektit: Znj. E. L. ka shlyer gjithë detyrimin për përfitim të padrejtë të pagës në vlerën 40,000 lekë në muajin nëntor 2023, nga paga e muajit tetor.

z. L. B. është shtuar tek lista e debitorëve duke qenë se nuk është më pjesë e stafit të institucionit, si dhe është larguar jashtë vendit.

Statusi: Zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës 237,418 lekë pa TVSH nga shoqëria “C.” SHPK, për volume punimesh të likuiduara, por të pakryera në fakt sipas kontratës Nr. 626 prot., datë 11.05.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

Pretendimi i subjektit: Me Faturën për arkëtim nr. 102 të datës 14.11.2024, është bërë pagesa e operatorit me vlerë 237,418 lekë.

Statusi: Zbatuar.

C.3. Masa për uljen e borxhit tatimor, për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

Rekomandimet nr. 1.1, që i përkasin kategorisë masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe

efektivitet të fondeve publike, të lëna në auditimin e mëparshëm të cilat nuk janë zbatuar dhe nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës totale prej 25,044,459 lekë, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, që i përkasin situatës së borxhit tatimorë. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkoher.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkia Libohovë, të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës 319,330 lekë, të cilat janë detyrime kontraktuale të pa paguara nga 5 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:

Pretendimi i subjektit

1. K. K. për vlerën 26,62 lekë; Pa arkëtuar
2. A. K. për vlerën 127,995 lekë; Arkëtuar
3. A. K. për vlerën 7,095 lekë; Arkëtuar
4. S. P. për vlerën 55,440 lekë; Pa arkëtuar
5. V. V. për vlerën 13,019 lekë. Arkëtuar

Statusi: Pjesërisht zbatuar

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të tyre.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Pretendimi i subjektit: Nuk ka patur më procese gjyqësore për dëmshpërblim në Bashkinë Libohovë.

Statusi: Zbatuar.

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Pretendimi i subjektit: Nuk ka patur më procese gjyqësore për dëmshpërblim në Bashkinë Libohovë.

Statusi: Zbatuar.

MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën **5,693,659 lekë.**

Pretendimi i subjektit: Bashkia Libohovë ka marrë masa për identifikimin e debitorëve dhe nxjerrjen e njoftimit vlerësimit tatimor për debitorët, por nuk është arkëtuar vlera 5,693,659 lekë.

Statusi: Pazbatuar.

2.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **138,887 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Pretendimi i subjektit: Nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës 138,887 lekë.

Statusi: Pazbatuar.

3.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore **374,003 lekë**, të cilat janë detyrime kontraktuale të papaguara nga 11 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:

1. M. N. për vlerën 53,050 lekë.
2. S. B. për vlerën 25,967 lekë
3. E. N. për vlerën 4,000 lekë
4. A. T. për vlerën 5,400 lekë
5. K. K. për vlerën 31,406 lekë
6. A. K. për vlerën 22,995 lekë
7. A. K. për vlerën 14,190 lekë
8. S. P. për vlerën 156,360 lekë
9. V. V. për vlerën 2,339 lekë
10. S. N. për vlerën 44,970 lekë
11. D. R. për vlerën 13,326 lekë

Pretendimi i subjektit: Për sa i përket rekomandimit të mësipërm kemi një mospërputhje me vlerat:

1. M. N. për vlerën 53,050 lekë (Arkëtuar)
2. S. B. për vlerën 25,967 lekë (Debitor)
3. E. N. për vlerën 4,000 lekë (Arkëtuar)
4. A. T. për vlerën 5,400 lekë (Arkëtuar)
5. K. K. për vlerën 31,406 lekë (Debitor me vlerën 21,840 lekë)
6. A. K. për vlerën 22,995 lekë (Arkëtuar)
7. A. K. për vlerën 14,190 lekë (Arkëtuar)
8. S. P. për vlerën 156,360 lekë (Debitor me vlerën 136,440 lekë)
9. V. V. për vlerën 2,339 lekë (Nuk rezulton debitor)
10. S. N. për vlerën 44,970 lekë; (Arkëtuar me vlerën 6,000 lekë)
11. D. R. për vlerën 13,326 lekë. (Arkëtuar me vlerën 3,360 lekë)

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

4.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë **1,769,280 lekë** të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

Pretendimi i subjektit: Me urdhër të kryetarit Nr.193 i datës 18.11.2024 një grup pune duke iu referuar listës së familjeve nga regjistri i gjendjes civile është bërë evidentimi nga grupi i punës duke u raportuar me proces-verbalin nr. 2285/1prot., datë 20.12.2024.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK SH.A Libohovë me qëllim që taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar” të mbliidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

Pretendimi i subjektit: Nga zyra përkatëse janë marr masa për negociata me Drejtorinë Rajonale të Ujësjellës- Kanalizimeve Gjirokastrë por kjo drejtori nuk e ka marr përsipër realizimin e kësaj akt-marrëveshje.

Statusi: Pazbatuar.

5.2.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 11,524,426 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Pretendimi i subjektit: Nga arkëtimi i debitorëve 2011-2023 , vlera e arkëtuar është 1,225,191 lekë.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

6.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Urban, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrin të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren.

Pretendimi i subjektit: Për sa i përket rekomandimit 6.1 zyra e tatim-taksave ka hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore.

Statusi: Zbatuar.

6.2.Rekomandimi: Sektori i tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **8,820,702 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 6.2 janë arkëtuar nga detyrimet e prapambetura për taksën e tokës bujqësore gjithsej 1,036,058 lekë.

Statusi: Në proces

7.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,431,000 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

Pretendimi i subjektit: Nga rakordimi me zyrën e tatim taksave dhe sektorin e Bujqësisë vlera e arkëtuar nga totali i debitorëve për tarifën e vaditjes në 2018-2023 është në masën 538.400 lekë.

Statusi: Në proces.

MASA DISIPLINORE.

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. “Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 2 punonjës:

1. Z. Xh. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenin 93, 94, 95, 131 të parashikuara në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Znj. F. B. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23, etj.

Pretendimi i subjektit: Titullari i Bashkisë me vendimin nr. 1, datë 20.01.2025, me nr. 109 prot.,

datë 20.01.2025 “Për mosfillimin e procedurës disiplinore” nuk ka vendosur masë ndaj punonjësve Xh. S. dhe F. B.

Statusi: Zbatuar.

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **1- ish punonjësin** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për:

1. Znj. E. P. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23, etj.

Pretendimi i subjektit: Rekomandimi i zbatuar.

Statusi: Zbatuar.

PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtorja e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Pretendimi i subjektit:

Duke qenë se ndaj punonjësve nuk janë marrë masa disiplinore, institucionet përkatëse nuk janë njoftuar.

Statusi: Zbatuar.

2. 4 Të tjera çështje përgjatë auditimit.

Gjatë kryerjes së fazës së auditimit në teren nuk rezultuan çështje të tjera për auditim.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e të pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Rregullorja e brendshme e bashkisë është e datës 20.08.2016 dhe nuk reflekton ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në strukturën organizative nuk është përcaktuar qartë ndarja e detyrave konkrete sipas secilës strukturë në veçanti, si dhe të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. Bashkia nuk ka hartuar strategjinë e menaxhimit të riskut dhe regjistrin e riskut, e për rrjedhojë nuk evidentohet e dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo

drejtues. Po ashtu, mungon vlerësimi i rreziqeve për mashtrime, si dhe kryerja e vlerësimeve periodike të ekspozimit ndaj tyre. Bashkia nuk disponon një sistem të brendshëm raportimi për shkeljet e rregullave apo raste të mundshme mashtrimi, duke kufizuar aftësinë e saj për të ndërhyrë në kohë dhe për të mbrojtur burimet publike. Bashkia nuk disponon një plan vjetor rekrutimi, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe menaxhimin efikas të burimeve njerëzore. Rekrutimet bëhen sipas nevojave të momentit, pa një analizë paraprake të burimeve dhe nevojave strategjike. Nuk është hartuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës dhe hartë e proceseve kryesore. Mungesa e sistemeve të informacionit (IT) funksionale përtej platformave qendrore si APP dhe SIFQ, si dhe mungesa e procedurave për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (back-up), përbën një tjetër rrisht të konsiderueshëm për sigurinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe administrativ.

Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të kontrollit të brendshëm për hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara për raportimin e shkeljeve të etikës dhe trajtimin e rasteve të mundshme të korrupsionit, si dhe krijimin e një mekanizmi të qartë për menaxhimin e këtyre ankesave në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale. Hartimin e një plani vjetor të rekrutimit, të bazuar në një analizë të nevojave reale të burimeve njerëzore dhe objektivave strategjike të institucionit. Vendosjen e një sistemi të brendshëm raportimi për shkeljet, që lejon identifikimin dhe reagimin në kohë ndaj çështjeve të ndjeshme. Investime në sisteme funksionale IT që plotësojnë nevojat specifike të bashkisë dhe ndërtimin e një politike për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (data back-up), për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e funksioneve administrative dhe financiare. Përgatitjen e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2024, nuk janë mbuluar me auditim aktivitetet që kryen Bashkia Libohovë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Prokurimeve, Sektorin e Tatim Taksave, Sektori i Bujqësisë, pasi për fusha të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Libohovë, të marrë masa që në planin vjetor të auditimit të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë si, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen në shumën 36,106,850 lekë, ndërsa llogaria analitike “Debitorë të ndryshëm” nga Drejtoria e Tatim-Taksave pasqyrohet në shumën 37,042,382 lekë, ku diferenca e konstatuar është në shumën 935,532 lekë, të cilat janë të pakontabilizuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet të shumës 935,532 lekë, si dhe të kryhen regjistrimet dhe rakordimet kontabël të debitorëve, çdo fund periodhe kontabël mes Sektorit të Financës dhe Drejtorisë së Tatim Taksave Vendore, me qëllim pasqyrimin e saktë të debitorëve në pasqyrat financiare.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” konstatohet se në pasqyrën e pozicionit financiar mbyllet me tepricë 0 lekë. Nga auditimi i pjesës së detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohen detyrime që shteti i ka institucionit për paga, kontribute dhe detyrime të tjera, totali i të cilave duhet të ishte kontabilizuar në debi të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e detyrimeve 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467, të cilat në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohen në shumën 14,422,295 lekë, nga të cilat 7,589,885 lekë janë keqklasifikuar në llogari të tjera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për pasqyrimin në pasqyrat financiare si të drejta, detyrimet për paga, sigurime shoqërore, shëndetësore, tatim mbi të ardhurat dhe detyrime të tjera afatshkurtra, që bashkia ka ndaj punonjësve dhe të tretëve në fund të periudhës kontabël, me qëllim pasqyrimin e saktë të Të Drejtave dhe Detyrimeve në pasqyrat financiare.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” konstatohet se transaksionet e kontabilizuara në këtë llogari i përkasin Furnizuesit të Shërbimit Universal në shumën 6,143,328,71 lekë, që janë shpenzime për energji elektrike për institucionin, të cilat kanë ndodhur në periudhat e mëparshme kontabël. Këto shpenzime në momentin e likuidimit të tyre ngarkojnë pa të drejtë shpenzimet e periudhës, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin e periudhës.

Gjithashtu, konstatohen shpenzime gjyqësore në shumën 2,676,886 lekë, për vendimin nr. 605, datë 19.04.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, detyrim i cili nuk është njohur në kontabilitetin e bashkisë, ndërkohë që janë bërë pagesa për ekzekutimin e këtij vendimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për pasqyrimin e saktë të detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrës së rezultatit.

Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrin masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” konstatohet se, transaksionet lidhur me rikonstrukcionin e Shkollës Nepravishtë që janë në punime në proces, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim, ndërkohë që janë kontabilizuar në shtesë të llogarisë 212 “Ndërtime e Konstruksiione”, në shumën 34,987,528 lekë. Konstatohet se diferenca në shumën 34,987,528 lekë duhej të ishte gjendje në llogarinë 231 në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, e për rrjedhojë gjendja e llogarisë 231 më datë 31 dhjetor 2024 duhet të ishte 352,221,635 lekë dhe jo 317,234,107 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e transaksioneve në shumën 34,987,528 lekë në llogarinë 231 “Për investime afatgjata materiale” sipas kërkesave dhe teknikave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përlllogaritjes së amortizimit të aktiveve afatgjata, rezultoi se janë llogaritur në mënyrë të gabuar amortizimet për të gjithë klasën e AAM, duke sjellë ndikim në gjendjen e aktiveve në PF. Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlëra neto)” konstatohet se: Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk i është nënshtruar amortizimit, duke bërë që vlëra kontabël të mos ndryshojë që nga njohja e transaksionit. Për llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” konstatohet se si metodë amortizimi është përdorur metoda me “Vlerë të mbetur” dhe normë amortizimi vjetore 1%. Për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, konstatohet se është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlerë të mbetur” dhe normë amortizimi vjetore 0.1%. Për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” konstatohet se nga pakësimet e vitit, shuma 18,354,906 lekë është keqklasifikuar në këtë llogarinë që në periudhat e mëparshme kontabël. Gjatë vitit 2024 janë bërë sistemimet përkatëse vetëm për në shumën 9,436,024 lekë, e cila është riklasifikuar, ndërsa diferenca në shumën 8,906,294 lekë nuk është debituar në asnjë nga llogaritë kontabël. Për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 4%. Për llogarinë 215 “Mjete transporti” konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 3%. Për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 8%. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, pika 36.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për kontabilizimin e diferencës në shumën 8,906,294 lekë, e cila nuk është debituar në asnjë nga llogaritë kontabël, si dhe të përlllogarisë saktë sipas normave të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe të kontabilizojë shpenzimet e amortizimit për aktivet afatgjata sipas kërkesave dhe teknikave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Fondit të Konsoliduar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrës së ndryshimeve në kapitalin neto konstatohet se, totali fondeve neto në të dy pasqyrat rakordon, por tepricat e llogarive të cilat ndikojnë dhe përbëjnë seksionin e tretë të pasqyrës së pozicionit financiar të cilat konvergojnë nga pasqyra e ndryshimeve në fondet neto nuk rakordojnë. Konstatohen diferenca mes së njëjtës llogari në të dyja pasqyrat duke bërë që të arrijmë në

konkluzionin se tepricat e pasqyruara nuk na japin një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2024. Konkretisht, u konstatua se llogaria 12 “Nga Rezultatet e mbartura” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 54,153,560 lekë, ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto pasqyrohet në shumën 171,556,243 lekë, pra konstatohet se e njëjta llogari ndryshon mes dy pasqyrave, diferencë e mbyllur brenda llogarisë nr. 101 “Teprica (fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar”. Llogaria 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 75,183,952 lekë, ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto pasqyrohet në shumën -45,212,625 lekë, pra konstatohet se e njëjta llogari ndryshon mes dy pasqyrave, diferencë e mbyllur brenda llogarisë nr. 101 “Teprica (fondi I akumuluar)/deficiti I akumuluar”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e transaksioneve dhe llogarive që lidhen mes pasqyrave financiare, në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar në fondin e konsoliduar dhe ndryshimeve që ndodhin gjatë periudhës kontabël në llogaritë e pasqyrës së ndryshimeve në fondin neto.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Fondit të Konsoliduar në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohet se llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 0 lekë; llogaria 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 0 lekë; llogaria 115 “Nga fondet e veta të investimeve” në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 0 lekë. Mbyllja me tepricë 0 lekë e llogarive të burimeve të financimit të investimeve, ndërkohë që investimet në proces janë në shumën 317,234,107 lekë është në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për sistemimin e transaksioneve të llogarive 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” dhe 115 “Nga fondet e veta të investimeve” me llogarinë 101 “Teprica (fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” në pasqyrën e pozicionit financiar, në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të fondit të konsoliduar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 7209 “Të tjera grante korrente të brendshme” konstatohet se përfaqësojnë të ardhura të trashëguara nga vitit 2023 në shumën 54,153,560 lekë. Këto të ardhura janë kontabilizuar një herë në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe kontabilizimi i tyre edhe në pasqyrat financiare të vitit 2024 sjell një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të të ardhurave të vitit ushtrimor 2024, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Nga auditimi i llogarisë 73 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit të Produkteve” konstatohet se është përfshirë në të ardhura në shumën -767,259 lekë, duke ndikuar në totalin e të ardhurave të realizuara

(në pakësim). Kjo shumë i korresponon ndryshimit të gjendjes së mallrave llogarisë 63 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit”.

Nga auditimi i llogarisë analitike 6029 “Shpenzime të tjera operative” konstatohen shpenzime për vendime gjyqësore në shumën 1,898,092 lekë, të cilat janë keqklasifikuar në këtë llogari. Kontabilizimi në këtë llogari sjell denatyrim të shpenzimeve, e për rrjedhojë një paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve të periudhës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat që në pasqyrën e performancës, të ardhurat dhe shpenzimet të pasqyrohen sipas rregullave dhe teknikave kontabël, në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pasqyrës së rezultatit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se niveli i realizimit të treguesve të shpenzimeve për vitin 2024 rezulton në masën 69.4%, pra në nivele mjaft të ulta, ku fondet buxhetore janë realizuar në shumën 180,653 mijë lekë kundrejt buxhetit të planifikuar në shumën 260,372 mijë lekë, me një mosrealizim në shumën 79,719 mijë lekë. Në këtë nivel realizimi kanë ndikuar:

a. Mosrealizimi i fondeve në llogaritë e shpenzimeve korrente, kryesisht në llogarinë 602 “Shpenzime për mallra dhe shërbime”, të cilat janë realizuar në masën 43.8%, llogaria 600 “Shpenzime për paga dhe llogaria 601 “Shpenzime për sigurime shoqërore/shëndetësore”, realizuar përkatësisht në masën 84.6% dhe 82.7%, të cilat tregojnë për parashikim përtej nevojave dhe një planifikim jo të saktë të këtyre shpenzimeve.

b. Llogaria 231 “Shpenzimet për investime” e realizuar në masën 66.3%, ku investimet janë përballuar kryesisht me burime nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale dhe transfertat e kushtëzuar. Investimet me burim financim të ardhurat e veta janë realizuar në masën 9.8%, nivel ky mjaft i ulët, pavarësisht nga fondet e trashëguara, kjo për arsye se një pjesë e investimeve janë prokuruar në fund të vitit 2024, duke mos u financuar ose financuar pjesërisht gjatë këtij viti.

Referuar treguesve të të ardhurave të trashëguara konfirmohet fakti se Bashkia Libohovë ka patur fonde në dispozicion për rritjen e performancës së realizimit të investimeve dhe nuk ka argumente justifikues për realizimin në nivele aq të ulta të këtyre fondeve, përveç mungesës së kapaciteteve dhe punës së pa mjaftueshme për vënien në eficiencë të fondeve brenda vitit ushtrimor, me qëllim rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit, në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me sektorët e tjerë të bashkisë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të shpenzimeve, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre treguesve dhe punës së strukturave të bashkisë të punohet për vënien në eficiencë të fondeve brenda vitit ushtrimor, me qëllim rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit e në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së rezultatit, seksioni i “Shpenzime të tjera” konstatohet se në këtë pasqyrë janë përfshirë operacione të korigjimit të rezultatit në shumën 39,534,328 lekë, të cilat nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të tilla, sepse kjo vlerë përbëhet nga transaksione për investime të financuara nga fondet buxhetore dhe jo nga fondet e veta. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Aneksi 1

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat që në pasqyrën e rezultatit, operacionet e korigjimit të rezultatit të pasqyrohen sipas rregullave dhe teknikave kontabël, në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të kësaj pasqyre, pasi ndikon në fondin neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë vetëm për totalin e fondeve neto me pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C. Konstatohet se në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet të dhënat e paraqitura nuk rakordojnë me të dhënat e llogarive kontabël për të pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar fondet neto gjatë periudhës kontabël.

Nga auditimi konstatohet se llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ (-)” nuk ka të kontabilizuar asnjë transaksion lidhur me vlerën e amortizimit të aktiveve afatgjata gjatë vitit ushtrimor, kjo llogari është rezultat i Pasqyrës së Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto) sipas normave të amortizimit të aplikuara. Aplikimi i normave jo të sakta të amortizimit të trajtuara në seksionin e aktiveve ndikon rezultatin e llogarisë 1013 “Nga konsumi i AAGJ”, i cili nga ana e tij ndikon llogarinë 101 “Teprica (Fondi i Akumuluar)”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat që në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto të pasqyrohen sipas rregullave dhe teknikave kontabël shpenzimet e amortizimit, në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë dhe të drejtë fondit neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve konstatohet se, kjo pasqyrë statistikore nuk është e plotësuar në mënyrë të saktë, që të japë një pasqyrim të plotë të të gjitha transaksioneve që kanë ndodhur gjatë vitit lidhur me burimet e financimit dhe investimet. Nga auditimi konstatohet se, në çelje të vitit ushtrimor veprimet kontabël në kredi të llogarive të burimeve për investime nuk rakordojnë me veprimet në debi të llogarive të shpenzimeve për investime. Teprica në fillim të vitit për shpenzime për aktive afatgjata materiale është 317,234,107 lekë, ndërsa teprica në fillim të vitit e burimeve për investime është 0 lekë. Nga auditimi konstatohet se veprimet në kredi të shpenzimeve për investime nuk janë të sakta, pasi janë konstatuar investime në shumën 34,987,528 lekë të cilat nuk kanë përfunduar akoma, pra që janë në proces, ndërkohë që janë kontabilizuar si të përfunduara. Rrjedhimisht, teprica në fund të vitit për shpenzime për investime nuk është e saktë. Nga auditimi konstatohet se në çelje të vitit ushtrimor llogaria 12 “Rezultat i mbartur” në shumën 44,312,956 është klasifikuar si burim për investimeve, ndërsa nga transaksionet e vitit nuk evidentohet asnjë transaksion të kontabilizuar për të kuptuar se si gjendja e kësaj llogarie është mbyllur në fund të vitit në shumën 54,153,560 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e

Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për të pasqyruar saktë investimet e kryera si dhe burimet e tyre sipas rregullave kontabël dhe që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore, me qëllim pasqyrimin e saktë të investimeve në pasqyrat financiare.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk është kryer inventarizimi i pronave të paluajtshme, të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 11.07.2007; nr. 272, datë 21.04.2010; nr. 706, datë 11.07.2007 dhe nr. 398, datë 13.05.2020.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e ndjekura për hipotekimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të transferuara me VKM nga pushteti qendror u konstatua se, Bashkisë Libohovë i janë transferuar në përdorim/pronësi 1693 asete, nga të cilat ka të regjistruara dhe pajisur me certifikatë vetëm 7 asete, rrjedhimisht dhe të inventarizuara. Për pjesën tjetër të pasurive të pa luajtshme dhe parcelat nga fondi pyjor/kullosor, nuk është kryer përditësimi i inventarit dhe nuk janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre, për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në DVASHK Gjirokastër. Gjithashtu, nuk ka vlerësim të pasurive të paluajtshme si ato të certifikuara dhe ato të pa certifikuara, duke mos evidentuar si aktive në PF me ndikim në pasqyrimin e gjendjes reale të pasurisë së kësaj njësie vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, Kreu I, pika 4, Kreu III, pika 35.

(Më hollësisht trajtuar në pikën .22, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Bashkia Libohovë nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të marrë masa për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar, të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, të fillojë përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre, si dhe për pasuritë e paluajtshme (AAGJM) të evidentuara në pasqyrat financiare, për të vijuar me aplikimet përkatëse në ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër, për pajisje me certifikatë pronësie. Më pas të vijohet me vlerësimin dhe kontabilizimin e aktiveve mbi bazën e dokumenteve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit konstatohet se, komisioni i inventarizimit është i njëjtë me atë të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, i ndryshuar, pika 97. Konstatohet se, anëtarë të komisionit të inventarizimit janë edhe dy punonjës të Sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MF, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82, si dhe me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, neni 22 “*Vëprimtaria e Kontrollit*”, pika 3. Nga ana e komisionit të vlerësimit nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, i ndryshuar, pika 103 – 106, pasi nuk janë hartuar relacionet për përfundimin e inventarizimit për Nëpunësin Autorizues. Gjithashtu, u konstatua se regjistri i aktiveve nuk është plotësuar në formën e kërkuar nga Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, i ndryshuar, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për shmangien e përfshirjes së punonjësve

në procese pune, të cilat i vendosin ata në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore dhe për uljen e riskut nga humbjet e keq menaxhimin e tyre.

Menjëherë e në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 435/9prot., datë 31.07.2024, bërë hyrje në Bashkinë Libohovë me shkresën nr. 678/15prot., datë 05.08.2024 për periudhën e auditimit 01.01.2023-31.12.2023, janë marrë masat dhe është përgatitur programi me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht: Janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuar referuar Urdhrit nr. 678/16 prot., datë 07.08.2024 të Kryetarit të Bashkisë Libohovë “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar”. Plan Veprimi i është dërguar Këshillit Bashkiak dhe strukturave përgjegjëse si drejtori, ndërmarrje, inspektorate e sektorë që të bëjnë analizë të punës së tyre. Një kopje e Plan Veprimit është dërguar dhe në KLSH me shkresën nr. 678/18, datë 30.08.2024, brenda 20 ditëve nga marrja e rekomandimeve. Bashkia Libohovë me shkresën nr. 678/1, datë 30.01.2025 “Zbatimin e Plan Veprimit dhe Raportimin në KLSH”, për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe Rekomandimeve, në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi rezulton se nga 37 masat e rekomanduara gjithsej, janë pranuar plotësisht të gjitha, ndërsa zbatueshmëria se tyre rezulton si më poshtë:

- Nga 20 masa organizative janë zbatuar 11 masa, janë në proces 2 masa, pjesërisht është zbatuar 1 masë, në proces zbatimi 2 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa. Nga 20 masat organizative të dhëna gjithsej, 9 masa i përkasin auditimit të mëparshëm (periudha 01.01.2023 deri më 31.12.2023), nga të cilat janë zbatuar 7 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 2 rekomandime, përkatësisht rekomandimi 1.1 dhe 5.1. Ndërsa 11 rekomandimet e tjera i takojnë periudhës së audituar 01.01.2021 deri më 31.12.2022 që rezultojnë të zbatuara 6, pjesërisht e zbatuar një masë, në proces zbatimi 2 masa dhe të pa zbatuara 6 masa. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.
- Nga 2 masa për shpërblim dëmi ekonomik, janë pranuar plotësisht dhe rezultojnë të zbatuara.
- Nga 1 masë për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) është pranuar dhe rezulton pjesërisht e zbatuar.
- Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, janë pranuar dhe zbatuar të 2 masat.
- Nga 9 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, është zbatuar 1 masë, 2 masa në proces zbatimi, përkatësisht masat 6.2 dhe 7.1; të zbatuara pjesërisht 3 masa: masat 3.1, 4.1 dhe 5.2, ndërsa të pa zbatuara rezultojnë 3, përkatësisht masat 1.1, 2.1 dhe 5.1.
- Për 2 masa disiplinore “Vërejtje” për dy punonjës në marrëdhënie pune, rezulton se nga Kryetari i Bashkisë nuk janë dhënë, ndërsa masa “Vërejtje” për një ish punonjës rezulton e ezauruar, pra rezultojnë 3 masa të zbatuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe të marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

Masat Organizative

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrit të Riskut, (iii) të ngrihet struktura e koordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut, (iv) të garantohet se njoftimi/ shpallja e vendeve të lira të punës, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

5.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për identifikimin e vlerave të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues për llogaritë ekonomike si vijon:

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë Libohovë. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, etj., në pronësi të Bashkisë Libohovë, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në pasqyrat financiare.

10.1.Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të hartohet regjistri kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administrojnë Bashkia Libohovë.

10.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin në terren e të gjitha pronave që administrojnë Bashkia Libohovë, për të përcaktuar dhe verifikuar situatën faktike, nëse ekzistojnë në teren të gjitha pronat ashtu si ato paraqiten në VKM përkatëse nëpërmjet të cilave janë transferuar në Bashkinë Libohovë. Në përfundim të procesit të inventarizimit të informohet Kryetari i Bashkisë për rezultatet e këtij procesi.

10.3.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga strukturat përkatëse të përgatiten dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të të gjitha pronave që administrojnë. Sektori i Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masat e duhura për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi për MFK, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

6.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e riskut nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

Masa për uljen e borxhit tatimor, për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkia Libohovë, të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës 319,330 lekë, të cilat janë detyrime kontraktuale të pa paguara nga 5 qiramarrësit e tokës bujqësore:

Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

1.1.Rekomandimi: *Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.*

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 5,693,659 lekë.

2.1.Rekomandimi: *Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 138,887 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.*

3.1.Rekomandimi: *Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 374,003 lekë, të cilat janë detyrime kontraktuale të papaguara nga 11 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:*

1. M. N. për vlerën 53,050 lekë

2. S. B. për vlerën 25,967 lekë

3. E. N. për vlerën 4,000 lekë

4. A. T. për vlerën 5,400 lekë

5. K. K. për vlerën 31,406 lekë

6. A. K. për vlerën 22,995 lekë

7. A. K. për vlerën 14,190 lekë

8. S. P. për vlerën 156,360 lekë

9. V. Ve. për vlerën 2,339 lekë

10. S. N. për vlerën 44,970 lekë

11. D. R. për vlerën 13,326 lekë

4.1.Rekomandimi: *Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksat/tarifat vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë 1,769,280 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.*

5.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK SH.A Libohovë me qëllim që taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.*

5.2.Rekomandimi: *Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 11,524,426 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.*

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të drejtave dhe detyrimeve rezultoi se, nga shuma progresive e debitorëve nga taksat, tarifatat vendore prej 25,120,891 lekë gjendje më 31.12.2024, nuk është kontabilizuar shuma 935,532 lekë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të Formatit 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” të pasqyrave financiare, duke mos u njohur si e drejtë e konstatuar për tu arkëtuar dhe për pasojë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatimeve dhe Taksave të marrin masa për identifikimin e saktë të debitorëve, detyrimi i të cilëve nuk është kontabilizuar në shumën 935,532 lekë, si dhe të marrin masa për arkëtimin e debitorëve që trashëgon bashkia.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.